



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor
“Fizioterapi”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti European i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Genc Burazeri

Prof. As. Irena Saço Kola

Korrik/ 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”, Universiteti European i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapise (Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Fizioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 539 datë 10.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim i parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (2020-2021)	19 PAE/ 3 PAK
18	Numri i studentëve: (2019-2021);	102 Student
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” është program i ciklit të parë që ofrohet nga Universiteti European i Tiranës, i hapur në vitin akademik 2018-2019 bazuar në Urdhërin e Ministrisë Nr. 539, datë 10.09.2018.

Programi ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, hapur me Urdhër Nr. 530, datë 04.09.2018 të Ministrisë të Arsimit. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi”. Departamenti ka përgatitur formën dhe suplementin e diplomës të cilat janë pjesë e dosjes së akreditimit, dhe do të miratohen pranë QSHA pas përfundimit të akreditimit, sipas akteve ligjore në fuqi.

Ky program synon formimin e specialistëve fizioterapistë, kurrikula e tij mundëson pajisjen me njohuritë themelore teorike dhe praktike të studentëve, prezantimin me praktikën bashkëkohore europiane dhe eksperiencën shqiptare në fushën e fizioterapisë, duke aftësuar studentët t’u përgjigjen kërkesave aktuale dhe prespektive për punësim në këtë sektor dhe të jenë konkures në tregun ndërkombëtar të punës.

Në mbështetje të programit të studimit, Universiteti ka ngritur sallat e praktikës dhe laboratorët për zhvillimin e lëndëve bazë, posaçërisht Laboratori i Fizioterapisë i pajisur me shtetërit e manipulimit, skeleti në formë mulazhi si dhe posterat me specifikime të pamjeve anatomike, etj., janë mjetet adekuate për demonstrimin dhe vënien në praktikë të njohurive të trajtuara. Universiteti e mbështet programin e studimit, edhe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione dhe qendra spitalore, më konkretisht: QSUT, Spitali Universitar i Traumës, Poliklinika Gjermane, Spitali Amerikan, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Spitali Salus, kryesisht për realizimin e praktikave mësimore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Grup ekspertësh: Prof. Asoc. Irena KOLA dhe Prof. Dr. Genc BURAZERI, si ekspertë të jashtëm të vlerësimit për këtë program studimi. Koordinatore teknike e ASCAL Znj. Aviola Bardhi.

Ekspertët e vlerësimit, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UET dhe në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, kanë kryer vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”.

Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga UET për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në Universitetin Europian të Tiranës në datën 25 dhe 28 Mars 2022. Gjatë kësaj dite u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, drejtuesit e Fakultetit, Departamentit, grupin e punës dhe stafin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

Takimet u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrat administrative të: Burimeve Njerëzore, Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zhvillimit të Projekteve, Zyra për Kujdesin ndaj Studentëve, si dhe vizitë në Bibliotekën e Universitetit dhe ambienteve mësimore.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas rubrikave përkatëse. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”, ofruar nga Unviersiteti Europian i Tiranës.


Më datë 31/05/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/66 Prot., datë 03/06/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 06/06/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 78/98 Prot., datë 06.06.2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Fizioterapi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1			
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Fizioterapisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, si dhe atyre të Departamentit të Infemierisë dhe Fizioterapisë. Programi promovon formimin akademik dhe shkencor bashkëkohor të studentëve mbështetur në prioritetet strategjike përkatëse, që lidhen me përgatitjen e fizioterapistëve me njohuri të përgjithshme dhe në fushën e fizioterapisë duke filluar që nga teoritë bazë dhe thellimin e tyre. <i>Ref. Dok. Nr. 3.3 Plani Strategjik UET 2021, Dok. Nr. 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor 2021-2025</i>		
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në vlerësimin tonë konfirmojmë se programi i studimit është në përputhje të plotë me misionin e UET të cilat synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, siç janë: respektimi i të drejtave themelore të njeriut, barazinë në shoqëri, traditat dhe simbolet kombëtare dhe të përgatisë fizioterapistëve të ardhshëm të standardit europian në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe përparimin e arsimit në nivel kombëtar. <i>Ref. Dok. Nr. 2 Statuti UET, Neni 6, Dok. Nr. 3.3 Plani Strategjik UET 2021, Vizioni, Dok. Nr. 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor 2021-2025, Objektivat Strategjike</i>		
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është në përputhje me Statutin dhe me Planin Strategjik 2015-2020 të UET, në të cilat theksohet se misioni i institucionit është “të përcjellë dije duke përgatitur jo vetëm studjues të përkushtuar, por edhe profesionistë të zotë” (RVB. faqe 5). Në vlerësimin e GVJ programi studimit Bachelor në “Fizioterapi” dallon për specifikën e tij të ndërthurjes së teorisë me praktikën. <i>Ref. Dok. Nr. 4 Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit, Misioni, Objektivat Strategjike të programit</i>		
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe /ose kombëtar.	Programi i studimit ofron një diplomë cilësore dhe bashkëkohore adekuate me kërkesat që kanë qendrat spitalore dhe shëndetësore publike dhe private në Republikën e Shqipërisë. Programi Bachelori në Fizioterapi jep dije dhe aftësi të profilizuara, si edhe të ndërthurura edhe me dije multidisiplinare duke nxitur zhvillimin ekonomik kombëtar. <i>Ref. Dok. Nr. 4 Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit, Dok. Nr. 17. Studimi i tregut të punës</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X



Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorezuar, konstatoi se Departamenti ka hartuar Planin Strategjik të zhvillimit të Programit, dhe vlerëson se programi ofrohet në përputhje dhe në zbatim me Planin Strategjik të institucionit 2021. Qëllimi i këtij Plani Strategjik për zhvillimin e programit është ta drejtojë zhvillimin e programit të studimit në “përvehtësimin e kompetencave teorike dhe praktike për të formuar një teknikë fizioterapie “ të aftë dhe të përgjegjshëm në trajtimin shëndetësor të pacientëve” që u bë e qartë në takimet me drejtuesit e institucionit dhe të Departamentit ku ky program realizohet. <i>Ref. Dok. Nr. 3.3 Plani Strategjik UET 2021, Dok. Nr. 4 Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit, Minutat e takimeve</i>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe Rregullorja e UET përcaktojnë objektivat akademike e kërkimore, qëllimet, misionin mënyrën e përmbushjes së përgjegjësive dhe shërbejnë si bazë për programin e studimit. Sipas dokumenteve referuese prioritet akademik është përcaktuar synimi që UET të veprojë si një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim në komunitet. UET e vlerëson performancën në kërkimin shkencor në bazë të indikatorëve më bashkëkohorë në këtë drejtim në përputhje me praktikën më të mira të universiteteve më të shquara në botën e zhvilluar, kriterëve e treguesve të politikave e standarteve europiane të kërkimit shkencor, vlerësimeve të biznesit dhe tregut të punës për vlefshmërinë e kërkimit shkencor, mendimet e sugjerimet e komunitetit të studentëve dhe ekspertëve të fushave të caktuara, etj. Kjo është në përputhje me përcaktimet në Ligjin 80/2015 të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. <i>Ref. Dok. Nr. 2 Statuti UET, Qëllimi dhe Objektivat, Dok. Nr. 5 Rregullore UET</i>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi studimit Bachelor në “Fizioterapi” (BA FIZ), emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja është në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit. Programi është i vendosur në Departamentin e Infermierise dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Kurrikula përmban orë teorike dhe praktike, në total 180 ECTS bazuar në VKM Nr. 41/2018. <i>Ref. Dok. Nr. 54. Urdheri 539, për hapjen e BA Fizioterapi, Dok. Nr. 14.3 Plani mesimor i programit BA Fizioterapi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e	Referuar dokumenteve të përgatitura nga UET dhe të depozituara në platformën online të ASCAL, në sistemin AMS, dhe pas diskutimeve me stafin e UET, GVJ vlerëson se Programi i studimit BA FIZ u mundëson

studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	studentëve Bachelor në Fizioterapi të marrin dije dhe aftësi të profilizuara, si edhe të ndërthurura me dije multidisiplinare. Për përmbushjen e kësaj strategjie janë përdorur literaturë bashkëkohore, si dhe janë angazhuar pedagogë mjekë dhe fizioterapistë ekspertë në këto fusha të cilët do të udhëheqin studentët në aftësimin e tyre duke përdorur metoda të mësimdhënies bashkëkohore dhe të praktikës fizioterapeutike, në bashkëpunim me institucionet shëndetësore publike dhe jopublike sipas marrëveshjeve respektive.			
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Nga takimi me Zyren e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) në UET dhe Njësinë me Marrëdhëniet me Studentët, si dhe referuar statistikave rreth gjurmimit të studentëve, GVJ vlerëson se studimet mbi tregun lokal të punës kryhen në mënyrë periodike. Staf i akademik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë (DIF) mban marrëdhënie të vazhdueshme me institucionet shtetërore dhe private Shëndetësore në qarkun e Tiranës por jo vetëm, duke mundësuar praktikën e studentëve si dhe ndjekjen e studentëve që janë punësuar pranë tyre. Gjithashtu ZKA është funksionale dhe aktive përmes këshillimit, informimit të vazhdueshëm, koordinimit dhe zhvillimit të pyetësorëve me studentët e diplomuar. <i>Dok.Nr 29 Monitorimi I ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre, Dok. Nr. 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit: QSUT, Poliklinika Gjermane, Spitali Universitar i Traumës, Spitali Salus, etj.</i>			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Referuar Rregullores së Programit të studimit BA në Fizioterapi me VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 (Dok.Nr. 7) dhe bisedave me drejtuesit e Fakulteti dhe Përgjegjësen e DIF, GVJ gjykon se objektivat formues të programit si dhe të gjithë elementët e tij struktura, përmbajtja, metodika që përdor në dhënie e dijeve, vlerësimin e tyre, u mundësojnë studentëve plotësimin e një profili të lartë profesional në funksion të nevojave dhe kërkesave të tregut të punës në Republikën e Shqipërisë. Programi realizon lidhjen e teorisë me praktikën profesionale pasi trajton cdo sistem human nga pikëpamja e rehabilitimit fizioterapeutik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën	Bazuar në treguesit e deritanishëm të akreditimit të vazhdueshëm institucional dhe programeve, si dhe në raportet vjetore të DIF për vitet 2018-2021, vlerësojmë se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe

<p>akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>burimet e nevojshme në funksion edhe të programit Bachelor në Fizioterapi. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përbëhet nga personel akademik i kualifikuar për të mbuluar modulet e programit BA Fizioterapi, gjithashtu angazhon anëtarë të personelit akademik nga fakultete të tjera të Universitetit.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, personeli akademik ne rang fakulteti përbëhet nga 22 PAE / 4 PAK.</p> <p>PAE: 1 – Prof. Dr. 2 – Prof. Asoc. Dr. 8 – Dr. 2 – Dr. Proces 9 – Msc.</p> <p>PAK: 1 – Dr. 3 – Msc.</p> <p><i>Ref. Dok.Nr 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit(Aneks_Tabela 1 dhe 2)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Studimet në Bachelor në Fizioterapi janë në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, si dhe me fushën akademike të njësisë kryesore, Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Përputhshmëria e programit në fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, është marrë në konsideratë gjatë hartimit të tij, duke u hartuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.</p> <p><i>Dok. Nr. 4 Plani Strategjik i Zhvillimit te Programit, Minutat e takimeve</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në vlerësimin e GVJ program i studimit ofrohet pranë Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, ku fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjitha programet e ofruara nga Deptamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë.</p> <p><i>Dok. Nr. 4 Plani Strategjik i Zhvillimit te Programit, Minutat e takimeve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UET ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, konfirmuar nga akreditimi institucional. Dokumentet rregullatorë, si Statuti i Universitetit dhe Rregullore e Universitetit përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, analizën dhe vlerësimin e vazhdueshëm, si dhe sistemin e karrierës bazuar mbi meritat. Organet kryesore dhe personeli akademik kanë mbështetjen e plotë nga struktura administrative e institucionit dhe vlerësimi i punës bëhet rregullisht si nga përgjegjësi i Departamentit edhe nga burimet njerëzore.</p> <p><i>Ref. Takimet ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga biseda me drejtuesit e UET dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ gjykon se për realizimin e programit BA Fizioterapi, Institucioni /Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e aktorë vendas dhe të huaj. Në kaudër të këtyre marrëveshjeve realizohen praktikat profesionale të studentëve , duke garantuar përfitimin jo vetëm të njohurive shkencore por edhe të aftësive dhe kompetencave që i përgjigjen tregut të punës.</p> <p><i>Ref. Dok. Lista e plotë e marrëveshjeve institucionale specifikohet në Shtojcën nr. 34.1-34.8</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë bisedës me stafin e DIF, GVJ u informua se shkëmbimet e mendimeve e vlerësimeve mes pedagogëve të praktikës profesionale dhe mbikëqyrësve të institucionit kanë sjellë përfitime në përmirësimin e programit të studimit duke iu përshatur kërkesave të tregut (<i>Raporti i përfitimeve në Shtojcën 35</i>). UET /Departamenti bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Aktualisht u gjetën të nënshkruara marrëveshje me institucione homologe si: QSUT, Spitali Universitar i Traumës, Poliklinika Gjermane, Spitali Amerikan, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore etj (<i>Dok.nr. 34.1-34.8</i>). Gjithashtu institucioni bashkëpunon edhe me aktorë e institucione të tjera, me të cilat pavarësisht se nuk ka marrëveshje të shkruara, kanë rënë dakord për të pranuar studentë për zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>Ref. Lista e studentëve dhe institucionet e zhvillimit të praktikës profesionale Dok. 32.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Përveç parashikimeve në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe me akte të brendshme, ku parashikohen të gjitha procedurat që duhet të ndiqen dhe roli i aktorëve e njësisve të ndryshme të përfshira në këtë proces. (<i>Dok.B.I Mbi praktikën profesionale Ref. Nr.32.2</i>). Praktikant mbikëqyren nga një pedagog i departamentit si dhe nga personi përgjegjës në insitucionin /kompaninë ku</p>



	zhvillohet praktika , bazuar ne marrveshjet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme shëndetësore, për vitet e dyta dhe të treta, ndërsa viti i parë bachelor praktikat i zhvillon në kabinetin e fizioterapisë në institucion. (Ref. Dok. Lista e plotë e marrëveshjeve institucionale specifikohet në Shtojcën nr. 34.1-34.8, Dok.B.I Mbi praktikën profesionale, pika B.1.3.1. dhe B.1.9 Nr. 32.2)			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për organizimin e lidhjeve mes universitetit dhe institucioneve ku ata janë punësuar. Institucioni në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka lidhur me institucione, organizata të tjera, vet departamentit dhe disa strukturave të tjera që ndihmojnë në këtë proces, të tilla si Bordet e Tregut të Punës, Klubet studentore, UET Alumni, ofron mundësinë e trajnimeve të certifikuara, jo vetëm për studentët e diplomuar, në UET ose jo, por edhe për studentët të cilët ende vazhdojnë studimet (Ref .Të dhëna për trajnimet profesionale Dok.Nr. 33)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ vlerëson se kurrikula e programit të studimit BA në Fizioterapi është e organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018. Programi i studimit si çdo program Bachelori ka një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike me 180 ECTS. Sipas Planit mësimor, lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 4 - 6 kredite (ECTS), praktikat klinike, me 8 kredite dhe provimi i përgjithshëm i formimit është vlerësuar me 7 kredite. GVJ konstatoi se në planin mesimor paraqiten qarte lëndet, ndarja për secilin prej tyre në leksione, seminare, laboratore, ore praktike/ projekte sipas semestrave, si dhe provimi i përgjithshëm perfundimtar me kreditet përkatëse (ku një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore dhe pune të studentit) <i>Ref. Dok. Nr. 14.3 Plani mesimor i programit;</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Kurrikula e programit të studimit është ndërtuar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve bazuar në Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar. Në program janë të parashikuara lëndë si; Hyrje në Psikologji, Shkrim akademik, Hyrje në Filozofi, Metodat e kërkimit, të cilat mundësojnë pajisjen me njohuri dhe shprehje komplementare. <i>Ref. Dok. Nr. 14.3 Plani mesimor i programit; Dok. Nr. 19. Syllabuset</i>
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	GVJ konstaton se programi i studimit BA në Fizioterapi, është strukturuar në mënyrë të tillë që të garantojë arritjen e objektivave ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushave të veprimit të fizioterapisë, me gërshetimin praktik të tyre. Studentët në përfundim të studimeve të tyre në Bachelor fitojnë njohuri teorike bazë të fushës së fizioterapisë, koncepte të aplikuara dhe të specializuara, përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e fizioterapisë me qëllim kualifikimin e mëtejshëm dhe punësimin e tyre. <i>Ref. Dok. Nr. 7 Rregullorja e programit të studimit, neni 3.3, Dok. Nr. 14. Kurrikula e programit të studimit BA Fizioterapi</i>
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e	Vlerësojmë se programi i studimit Bachelor në Fizioterapi, duke që programi i ciklit të parë, ia ka arritur që në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve të aftësojë studentët për mendim profesional, të menduarit kritik, për menaxhimin e pacientëve për trajtim teknik dhe profesional shëndetësor, si dhe të marrin përgjegjësi për të qenë pjesëmarrës në trajtime dhe protokolle spitalore.

problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<i>Ref. Dok. Nr. 14. Kurrikula e programit të studimit BA Fizioterapi, Takimi me drejtuesit, Takimi me studentët e programit</i>			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Në përmbushje të kërkesave ligjore, Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi, është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, (neni 73). Programi ofrohet me 180 ECTS, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Ky program studimi mbyllet me provimin e përgjithshëm të formimit/provimin përfundimtar, dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë Bachelor në "Fizioterapi". <i>Ref. Modeli i Diplomës-Modeli i Suplementit (Dok. Nr. 15)</i>			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Analiza e të dhënave mbi lëndët, ngarkesat përkatëse në kredite dhe kategoritë e përcaktuara në kurrikulën e programit tregon se ato janë gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Bazuar në VKM nr 41 datë 24.01.2018. Lëndët e programit të studimit janë të organizuara në kategori disiplinash dhe me kreditet përkatëse. Studentët që përfundojnë studimet në Bachelor në "Fizioterapi", diplomohen me 180 ECTS. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt /detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. <i>(Plani mësimor i programit Bachelor në Fizioterapi (Dok. Nr. 14.2)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, dhe takimet gjatë vizitave në institucion, Grupi i Vlerësimit konfirmon se Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë zhvillon veprimtaritë e tij të përcaktuara dhe në aktet e brendshme rregullatore të Universitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Ky departament është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, fakulteti i cili është krijuar me urdhër të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 530 datë 04.09.2018. UET është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017. Pas hapjes së Fakultetit të ri të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenteve të tij, Universiteti u akreditua me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2019. Ndërsa programet e studimit në këtë fakultet janë programe të reja të hapura në vitin 2018, të cilat kanë kaluar ose po kalojnë në proces akreditimi. <i>Ref. Dok.Nr. 54.3 – 54.5, dokumente te akreditimit te institucionit, Dok. Nr. 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse_Tab 3</i>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore /bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi që bazuar në aktet e brendshme rregullatore të Universitetit e në zbatim të VKM Nr. 531, Dt 11.09.2018 “Përmiratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë, Standarti II.2, Kriteri 2, programit i është caktuar një Koordinator që në fillim të aktivitetit të tij. Detyrat e kordinatorit të programit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit dhe në aktet rregullatore të UET. Koordinatori shqyrton cilësinë e silabuseve përpara miratimit të tyre, miraton temat e eseve, tezat e provimeve, vlerëson ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale. Këto detyra ishin përputhje me kuadrin rregullator ligjor e përmbushen rregullisht gjë që u konfirmua nga GVJ gjatë takimit me stafin akademik, vetë koordinatorin e programit drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit.</p> <p><i>Ref. Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit Dok.Nr 36); Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2 Dok.Nr 6, Takimet në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>DIF si njësia bazë përgjegjëse për ndjekjen e programit, i përmbush detyrimet që burojnë nga aktet ligjore, si dhe nga dokumentet statutoare dhe rregulloret e institucionit. Po ashtu dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përmbush detyrimet ligjore sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 për të ofruar programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”, si edhe për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është i përbërë nga dy Departamente dhe Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik, përkatësisht: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Imazherisë dhe Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik.</p> <p><i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 1 (Ref.Nr. 23)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave GVJ konstatoi se DIF përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. DIF ka në përbërje aktualisht 10 anëtarë personel akademik efektiv, 7 me kohë të plotë, nga të cilët: 3 Dr., 4 Msc dhe 3 me kohë të pjesshme: 1 Dr me kontratë dhe 2 Ast/ lektorë Msc.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit për vitin 2020-2021, ka patur përbërjen si vijon: 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 1 Prof. Dr., 1 Prof.As.Dr., 1 Dr. dhe 4 MSc; si dhe 7 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët; 1 Dr. dhe 6 MSc.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit për vitin 2019-2020, ka patur përbërjen si vijon: 8 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 2 Prof. Dr., 1 Prof. As.Dr., 1 Dr. dhe 4 MSc; si dhe 10 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët; 2 Prof.Dr., 1 Prof.As.Dr., 2 Dr. dhe 5 MSc.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit për vitin 2018-2019, në hapje të tij, ka patur përbërjen si vijon: 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 1 Prof. Dr dhe 6 Dr.; sidhe 4 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët; 1 Prof. Dr., 1 Prof. As. Dr., 1 Dr. dhe 1 MSc.</p> <p><i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 2 (Ref.Nr. 23)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave GVJ konstatoi se DIF përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. DIF ka në përbërje aktualisht 10 anëtarë personel akademik efektiv, 7 me kohë të plotë, nga të cilët: 3 Dr., 4 Msc dhe 3 me kohë të pjesshme: 1 Dr me kontratë dhe 2 Ast/ lektorë Msc.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit për vitin 2020-2021, ka patur përbërjen si vijon: 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 1 Prof. Dr., 1 Prof.As.Dr., 1 Dr. dhe 4 MSc; si dhe 7 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët; 1 Dr. dhe 6 MSc.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit për vitin 2019-2020, ka patur përbërjen si vijon: 8 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 2 Prof. Dr., 1 Prof. As.Dr., 1 Dr. dhe 4 MSc; si dhe 10 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët; 2 Prof.Dr., 1 Prof.As.Dr., 2 Dr. dhe 5 MSc.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit për vitin 2018-2019, në hapje të tij, ka patur përbërjen si vijon: 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 1 Prof. Dr dhe 6 Dr.; sidhe 4 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët; 1 Prof. Dr., 1 Prof. As. Dr., 1 Dr. dhe 1 MSc.</p> <p><i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 2 (Ref.Nr. 23)</i></p>



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore /bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ nga biseda me stafin akademik të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë vlerëson se ai zotëron informacionet e duhura në lidhje me programin mësimor të BA në Fizioterapi. Kjo u konfirmua jo vetëm nga biseda e GVJ me stafin akademik të Departamentit, por edhe nga takimet me studentët dhe njësitë e tjera mbështetëse të UET. Të gjitha informacionet gjenden edhe në databazën e ASCAL si Rregullorja e programit të studimit Fizioterapi (<i>Dok.Nr 7 Rregullore e programit</i>), Plani mësimor i programit të studimit Fizioterapi (<i>Dok.Nr 14.2 Plani mësimor i programit</i>), GVJ konstatoi të dhënat e programit të publikuara në faqen e internetit (https://uet.edu.al/ëp-content/uploads/2021/09/BA-Fizioterapi.pdf).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar Aneksit mbi Tabelat Përmbledhëse të Programi Bachelor në Fizioterapi vlerësojmë se ai përmban 30 lëndë, përfshirë Praktikat klinike I dhe II. Lëndët dhe ngarkesa përkatëse e tyre brenda kurrikulës janë në përputhje të plotë me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Sipas ngarkesës mësimore të lëndëve në kurrikul dhe vlerësimeve të kryera, rezulton se lëndët bazë (A) zenë rreth 17.8% të krediteve, lëndët karakterizuese (B) të programit përbëjnë 51.1% të krediteve, lëndët ndërdisiplinore (C) kanë një përqindje 13.3% të krediteve dhe lëndët plotësuese 13.8% si dhe detyrimet përmbyllëse 3.9%. <i>Ref. Dok. Nr. 14.4 Plani mesimor sipas veprimtarive formuese, VKM 41/2018.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit BA në Fizioterapi është i organizuar në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara me kredite brenda e jashtë auditorit për arritjen e rezultateve sipas volumit të punës mësimore. Ato bazohen në natyrën e lëndës, si lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore-integruese dhe plotësuese.
Kriteri 4. Programet e studimit përbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor /jashtë auditorit, frekuentimin /ndjekjen	Programi BA në Fizioterapi është i detajuar në të dhënat që lidhen me planin mësimor, ngarkesën mësimore, orët, frekuentimin, ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe syllabuseve jepen informacione në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij për çdo lëndë. Përsa i përket mënyrës së vlerësimit të dijeve dhe kriteret e frekuentimit i gjejmë të specifikuar në <i>syllabuset e lëndëve, Rregulloren e programit të studimit (Pika 5, Pika 6), dhe Rregulloren e UET (Neni 24, 25)</i> . Kryesisht vlerësimi bazohet në një sërë

e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	indikatorësh përfshirë testet, ese, detyra, punë në grup, projekte dhe provimi final, që tregon metodat e larmishme të përdorura gjatë procesit mësimor. Në Rregulloret Tranzitore (<i>Dok Nr. 5.2 dhe 5.3</i>) për vijimin e procesit akademik në kushtet e Pandemisë COVID-19, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit ka vijuar të mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, dhe nota përfundimtare ishte kombinim i elementëve: a) Lëndët e tipologjisë I - Detyrë praktike 1x30% - Provim përfundimtar 70% b) Lëndët e tipologjisë II: - Aktivizimi gjatë procesit mësimor 10% - Detyra e kursit 20% - Provimi përfundimtar 70%			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi ka të gjithë informacionin e duhur adresuar studentëve mbi kriteret e përgjithshme, specifikat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kushtet dhe kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në Fizioterapi janë të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit (<i>Dok. Nr. 7, Pika 2 dhe Pika 9</i>) dhe aktet e brendshme rregullatore të Uniersitetit (<i>Dok. Nr. 5, Kreu III, dhe Kreu VII; Dok. Nr. 28. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitet</i>).Kjo u konfirmua edhe nga biseda me sekretarinë, GVJ konstatoi se ato pasqyronin saktë numrin e studentëve të pranuar, me te dhëna të plota referuar dosjeve të tyre.			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi Ba në Fizioterapi i përmban të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara në këtë kriter të cilat janë të specifikuar në shpallura e të aksesueshme edhe në faqen online të UET. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me objektivat e lëndës, tematikat e leksioneve dhe seminareve, orët brenda dhe jashtë auditorit, etj. Ato janë formalisht të unifikuar në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu syllabuset e lëndëve përcaktojnë strukturën e notës përfundimtare bazuar në totalin e vlerësimeve për testet paraprake, kolokiumet, esetë, detyrat, projektet dhe provimin final. Syllabuset kanë të njëjtin format dhe kanë të specifikuar literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar (<i>Dok.Nr 19 Syllabuset e Lëndëve</i>).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e DIF konstatoi praktikën e punës se në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i programit të studimit, ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në përmbajtje të silabuseve - duke përfshirë kontributin e aktorëve të ndryshëm, vet stafin akademik, studentët e programit, këshillimet me Bodin e Tregut të Punës. Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi nuk ka bërë ndryshime në planin mësimor në vitet akademike 2018-2021 për arsye të kufizimeve ligjore lidhur me akreditimin (<i>referuar Aneksit 1, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 11</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi BA në Fizioterapi është strukturuar me 180 ECTS në total, çdo 1 ECTS përbëhet nga 25 orë ngarkesë, ngarkesa në auditor si dhe ngarkesa e nevojshme për studim individual, duke qenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo konstatohet në kurrikulën e programit të studimit dhe në planin mësimor të tij. Në planin mësimor, specifikohen ngarkesat e orëve totale në auditor dhe për punë të pavarur, të cilat vlerësohet se janë në përputhje me parashikimeve nënligjore në fuqi, ku jo më pak se gjysma e orëve zhvillohen në auditor. <i>Ref. Dok. Nr. 14. Kurrikula e programit të studimit, Dok. Nr. 14.2 Plani mësimor, Tabela 13.</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Programi BA në Fizioterapi përbëhet nga lëndë që adresojnë qëllimin e tij në formësimin e dijeve teorike e aftësive praktike dhe që janë në përputhje me fokusimin në tregun e punës të studentëve të diplomuar. Shpërndarja e lëndëve bazë, që ofrohen kryesisht gjatë vitit të parë dhe të dytë në këtë program studimi, vijon me lëndët karakterizuese të programit, specifike në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Studentëve u kërkohet rregullisht që të përgatisin projekte, detyra dhe ese në të gjitha lëndët, që së bashku me praktikat profesionale në fund të vitit të dytë dhe të tretë, përbëjnë një mundësi të aftësimin profesional.
Kriteri 3. Lëndët /modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Elementët përbërës të programit (lëndët, shpërndarja në semestra e vite, kreditet, etj), e mundësojnë arritjen e objektivave të tij. Semestri i parë fillon me hyrje në njohuritë në psikologji, biologji humane, metoda kerkimi, shkrim akademik, biofizik, statistike e aplikuar. Pastaj në vitin e dytë zhvillohen lëndë karakterizuese të lidhura me principet në patologji të caktuara, biomekanike dhe kineziologji. Në vitin e tretë, vazhdohen me lëndët me karakter rehabilitues. <i>Ref. Dok. Nr. 14. Kurrikula e programit të studimit, Dok. Nr. 14.2 Plani mësimor</i>
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre është në përputhje me profilin e programit “Bachelor”, duke pasur si risi të tij fokusimin në përgatitjen e teknikienit fizioterapist në rehabilitimin e patologjive apo situatave post-operatore të ndryshme. Raporti teori-praktikë është i balancuar me punën e pavarur jashtë auditorit të studentëve dhe praktikën mësimore. Gjithsesi formimi në 3 vite i lejon studentët të marrin konceptet dhe aftësitë e nevojshme profesionale të aftë për të dalë në tregun e punës.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Programi BA në Fizioterapi ka ndërthurje pozitive midis veprimtarisë formuese dhe trajtimit praktik të patologjive dhe rehabilitimin e tyre. Orët mësimore sipas planit mësimor (<i>Tabelat Përmbledhëse Nr. 13</i>), ndahen në orë mësimi në auditor (leksione /seminare) dhe orë studimi jashtë auditorit, si dhe 20 orë provimi i diplomës. Orët në total janë 4500 që i korrespondojnë 180 krediteve. Vemendja ndaj praktikës profesionale mundëson një lidhje

mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	midis teorisë dhe praktikës, si dhe punësim e studentëve në përfundim të studimeve, sikurse rezultojn nga përvojat e DIF.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve /moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rregulloreve dhe takimeve të zhvilluara, GVJ konstaton se stafi akademik aplikon rishikimin dhe përbajtjes së syllabuseve dhe përditësimin e literaturës së lëndëve. Sipas shpjegimeve të stafit akademik të DIF, në rastet kur mungon një tekst bazë i përditësuar, por edhe kur literatura bazë është e përditësuar, stafi akademik përdor si literaturë mbështetëse artikuj shkencorë të publikuar në 5 vitet e fundit në revista shkencore dhe të përkthyer nga pedagogu i lëndës. <i>(Takimi me stafin akademik)</i>			
Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara në nivelin bachelor. Referuar programit me lëndët respektive në çdo semestër, njohuritë vijnë duke u thelluar dhe zgjeruar nga një semestër në tjetrin, nga hyrjet në filozofi, psikologji, metoda kërkimi, statistikë e aplikuar etj. Njohuritë përforcohen me zhvillimin e aftësive profesionale dhe teknike rehabilituese. <i>Ref. Dok. Nr. 14. Kurrikula e programit të studimit</i>			
Kriteri 8. Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi u jep studentëve njohuritë që mund të merren në një sistem Bachelor, i ndihmon ata për studime të avancuara, si dhe asiston ambiciet e studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës. Stafi akademik dhe studentët sollën shembuj studentësh që kishin vazhduar studimet Master apo që ishin punësuar si në institucione shëndetësore publike dhe jopublike. Konkretisht DIF ofron programin Master Shkencor në Fizioterapi me 120 ECTS. <i>Ref. Dok. Nr. 14. Kurrikula e programit të studimit</i>			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përmes anketimeve me studentët e diplomuar, forumeve dhe diskutimeve me partnerët nga tregu i punës me të cilët ka marrëveshje institucionale, njëësia bazë dhe institucioni konsultohen vazhdimisht me propozimet për nevojat dhe pritshmëritë e tregut të punës. Duke bërë rregullisht gjurmimet e studentëve të diplomuar dhe përmes marrëdhënieve të ngushta. Departamenti merr në konsideratë mendimet propozimet e anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës dhe konsultohet me ta, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme, me qëllim lehtësimin e përfshirjes së studentëve në tregun aktual të punës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të	Nga të dhënat e vena në dispozicion për personelin akademik si dhe biseda me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi si me kohë të plotë,

<p>pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>ashtu dhe me kohë të pjesshme, konfirmojnë se ata përmbushin kërkesat ligjore të Ligjit 80/2015, Nenit 59, mbi kategoritë e personelit akademik. Referuar shpjegimeve në detaje të <i>Tabelës Përmbledhëse</i>, GVJ konstatoi se ngarkesa e stafit të brëndshëm ka diferenca të vogla nën apo mbi normë. Një pjesë e pedagogëve PAE janë nga fakultetet e tjera brenda UET, ndërsa PAK vjen ose nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, ose nga Universiteti i Mjekësisë (UM).</p> <p>Raporti PAE/PAK, qëndron në shifrat 86.3% /13.7% që përmbush kriteret dhe tregon qartësisht se stafi akademik i brëndshëm i departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë ka kapacitete të plota për realizimin e programit Ba në Fizioterapi.</p> <p>Në vitin e fundit akademik 2020-2021 ka një prirje të rritjes së peshës specifike në numër të PAE (19 pedagogë) në raport me PAK (3 Pedagogë). Sa i takon ngarkesës së lëndëve të programit mësimor, PAE ka një angazhimin mbi 80% të lëndëve dhe PAK ka mbulimin e lëndëve të programit në rreth 20%. Nga takimi me studentët u konstatua se ata ishin vlerësues për cilësitë e stafit akademik.</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, pedagogët e angazhuar në mbulimin e ngarkesës mësimore të programit janë 21 gjithsej, nga ku 20 prej tyre janë PAE dhe 1 PAK. Stafi PAE, ka mbuluar mbi 95 % të ngarkesës mësimore në program, në raport stafin PAK (1 lëndë).</p> <p>Nga shqyrtimi i të dhënave për pedagogët e angazhuar në vitin akademik 2018-2019, në 15 pedagogë janë angazhuar 13 PAE dhe 2 PAK. Stafi PAE i angazhuar mbulon mbi 90 % të ngarkesës mësimore, në raport me stafin PAK (2 lëndë).</p> <p>Gjithasthu dhe raportet numerike PAE/PAK gjatë 3 viteve të fundit akademike, ruajnë një përqindje të lartë në favor të stafit të brëndshëm të Universitetit.</p> <p><i>(Ref. Nr. 24/Tabelat 12 dhe 6 dokumenti 02. Aneks Tabelat përmbledhëse)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>PAE dhe PAK në programin BA në Fizioterapi kanë një shpërndarje në tituj dhe grada: 2 Prof. Dr., 6 Dr, 1 Dr (process), 10 asistent lektorë me MSc., si dhe 3 personel akademik me kontratë, nga të cilët: 1 Dr, 1 MSc (Specializante) dhe 1 MSc. Po ashtu, diplomimi i stafit akademik përkon me fushën e studimit të programit BA në Fizioterapi mbështetur në të dhënat e stafit dhe kualifikimet, CV të përditësuara deri në Maj, 2021 sipas <i>(Të dhëna për personelin akademik të programit (Ref. Nr. 24/Tabelat 12 dhe 6 dokumenti 02. Aneks Tabelat përmbledhëse); CV të personelit (Ref. Nr. 20).</i> Gjithasthu në lidhje me drejtimin dhe titullarët e fushave të studimit në këtë program studimi, angazhimi i personelit specifikohet në Rregulloren e UET.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në</p>	<p>Niveli i kualifikimit të personelit akademik të programit të studimit BA në Fizioterapi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij dhe ka një përvojë pedagogjike relativisht të gjatë. Fusha akademike dhe ajo kërkimore e personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme që mbulon programin e studimit përkojnë me lëndët dhe kërkimet që ata zhvillojnë aktualisht.</p>

përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Ref. CV të personelit (Ref. Nr. 20)			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Në bazë të kurrikulës së programit të studimit BA në Fizioterapi, studentëve iu ofrohet udhëheqje e Praktikës Profesionale dhe në përgatitjen për diplomim. Mbikëqyrja dhe ndjekja e këtyre seancave kryhet nga një pedagog, i caktuar nga departamenti, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës. Programi i studimit BA sipas legjislacionit në fuqi përfundon me provim diplome dhe vetëm në raste të studentëve të shkëlqyer me punim diplome. Studentët mund të realizojnë temën e diplomës sipas kriterit të përcaktuar nga DIF me mesatare mbi 8.5.</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, me ndihmën e Zyrës së Karrierës, nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe kompani private, garanton jo vetëm akomodimin e studentëve në këto institucione, por gjithashtu nga takimet me drejtuesit, pedagogët dhe studentet u konstatua se organizohen rregullisht leksione të hapura në auditor, workshope, forume me perfshirjen e eksperteve të fushës së mjekesise/ së fizioterapise, duke përçarur njohurite, praktikën dhe eksperiencën e tyre më të mire tek studentët.</p> <p>Ref. Dok. Nr. 7 Rregullore e programit, Pika 7 dhe Pika 8, Dok nr. 34.1 – 34.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit, Dok. Nr. 35 Raporti I përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Institucioni angazhon rregullisht asistentët, sipas programit mësimor dhe detyrimeve të përcaktuara në departament. Për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi, parashikohen dhe zhvillohen orë laboratorike, të cilat zhvillohen nga stafi akademik. Gjithashtu, në nivel fakulteti dhe institucioni ka zyra përgjegjëse, që merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p>(vizita në IAL)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së Mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Në databazën e ASCAL janë të shqyrtuar një seri Rregulloresh të hartuara dhe miratuara nga UET në përputhje me Ligjin 80/2015 mbi bazën e të cilave GVJ gjykon se UET disponon gjithë kuadrin e nevojshëm të brendshëm rregullator. Në rregulloret e Universitetit dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët del qartë se institucioni ka politika të konsoliduara për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe të qasjeve inovative. Këtu mund të përmenden udhëzuesit e hollësishëm për hartimi e silbuseve, metodave të mësimdhënies, përzgjedhjes së literaturës së detyruar dhe rekomanduar (<i>Dokumenti Nr. 39 A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i>), sistemit të kontrollit të dijeve (<i>dokumenti Nr. 7.2 A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve</i>), këshillimit akademik dhe tutoriatit (<i>Dokumenti Nr. 12 E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>), etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Në nivelin e njësisë bazë, mësimdhënia dhe aftësitë inovative të personelit akademik vlerësohen rregullisht për të përmirësuar cilësinë nga Përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore, Përgjegjësi i Departamentit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe studentët. Në kushtet e mësimin online për shkak të COVID19, stafi akademik i programit BA në Fizioterapi u trajnuar për përdorimin e shërbimeve që lidhen me mësimin online, sikurse u konfirmua gjatë bisedës me stafin akademik. (<i>Takimi me stafin akademik</i>)
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Sipas praktikës së konsoliduar të institucionit çdo fund semestri studentët marrin pjesë në anketën e vlerësimit të çdo lënde përmes të cilës maten treguesit cilësore dhe profesionale të stafit akademik, të moduleve dhe të metodave të mësimdhënies. Studentët janë pjesëmarrës aktivë dhe e konsiderojnë këtë si një instrument konstruktiv ndërveprimi. UET ka zhvilluar anketime online edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Të gjitha këto u konfirmuan nga studentët dhe gjenden në (<i>Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. 40)</i>). Sa i përket ankesave individuale për vlerësimin e marrë në kuadër të lëndëve të zhvilluara, studenti i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit, mbështetur në nenin 32 të Rregullores së UET.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit përmes anketës dhe strukturave për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, pasi përpunohen nga KSBC, apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve online i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme. Këto praktika u konfirmuan dhe nga takimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Fakultetit /Departamentit. (<i>Takimi me stafin akademik dhe KSBC</i>)
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të	Institucioni bazuar në performancë mbështet stafin akademik në promovimin individual. Nga biseda me stafin akademik ai konfirmoi mbështetjen e

marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	institucionit për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, si shkëmbime në kuadër të programeve Erasmus+, etj. Nga ana tjetër, personeli akademik i ri është asistuar në mësim nga lektorë me përvojë, me qëllim transferimin e përvojës dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies. (Takimi me stafin akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi mësimor zhvillohet përmes një kombinimi të leksioneve, seminareve, detyrave të lëndës, projekteve dhe aktiviteteve të tjera, sikurse u konfirmua nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, bisedave me stafin akademik dhe studentët. Leksionet e hapura, debatet publike me ekspertë të ftuar njohur të fushës, si dhe forumet profesionale dhe në nivel studentor janë pjesë e formave të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve. Institucioni ka një faqe interneti shumë të pasur në informacion dhe me akses të plotë në sistemin e brendshëm nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Në bazë të planit mësimor, shpërndarja e orëve në auditor sipas formave të mësimdhënies është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 630 orë - Seminare 373 orë - Laboratorë/Ushtrime 163.2 orë - Praktika/Detyra 447.6 orë - Praktika klinike 400 orë - Diploma/Provim formimi 20 orë <p>Total 2033.8</p> <p>Institucioni mbikqyr që programet e lëndëve të ndërtohen mbi bazën e elementëve në rregullore dhe procesi mësimor të zhvillohet mbi bazën e tyre.</p> <p>Raporti teori/praktikë: 650 orë mësimore teori / 1383.8 orë mësimore praktikë = 32 % / 68 %</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 14.2 Plani mesimor i programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e</p>	<p>Institucioni ndër vite ka dëshmuar aftësi të bashkëveprimit në diversitet kulturor të stafit akademik, duke krijuar një klimë pozitive dhe mbështetëse për krijimin e klimës së përshtatshme të diversitetit edhe tek studentët. Në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, krahas metodave klasike të mësimdhënies rritet kontakti i drejtpërdrejtë i studentëve me anë të praktikave spitalore, forumet UET me figura të njohura të fushës, me anë të klubit të Mjekësisë "Hipokrati", si forma të tjera të mësimdhënies /mësimnxënies. Projekte studimi në grup, mjete audio-vizive, shfrytëzimi i laboratorëve për secilën lëndë etj.</p> <p>(Takimi me stafin akademik)</p>

aktiviteteve formuese në veçanti.	
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Universiteti organizon në mënyrë periodike Staff Development Day – Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synim trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Gjithashtu në fillim të vitit akademik, universiteti organizon edhe trajnimin dy ditor “Back to work”. Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes.</p> <p><i>(Të dhëna për shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi vjen nga përvoja akademike në vende të ndryshme dhe me përvojë të gjatë profesionale, çfarë i mundëson atij të zotërojë njohuritë e nevojshme në funksion të jetësimit të programit. Përgjegjësi i departamentit organizon kontrole periodike të mësimin duke dhënë vlerësime të kompetencës së pedagogëve për lëndët që ofrojnë. Po ashtu, logjistika që pamë, kryesisht pajisja me projector e cdo klase, ndihmon në shpjegimin qartë të koncepteve dhe njohurive për përcjelljen e dijeve tek studentët. Përdorimi i platformave Lms e Teams në mbështetje të mesimdhënies online gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19 ka siguruar mundësi shumë të mira sipër pedagogët dhe ashtu për studentët për zhvillimin me cilësi të procesin mësimor. Kjo u konstatua dhe nga bisedat me stafin dhe studentet. <i>(Takimi me stafin akademik dhe studentet)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti ka bërë përpjekje për të krijuar lidhje të qëndrueshme midis stafit akademik dhe moduleve/ lëndëve kryesore. GVJ konstatoi se stafi ka një ngarkesë brenda normës. Vlerësimi i formave dhe metodikës së mësimdhënies realizohet përmes anketës së vlerësimit çdo fund semestri nga studentët, si dhe formës tradicionale të prezencës të autoritetit drejtues gjatë realizimit të leksionit /orës së mësimin, si dhe diskutimi i tyre për të ndërmarrë hapa përmirësues për të ardhmen. Mendimi i studenteve për çështje të caktuara, shqetësimet e ngritura nga studentet, marrin vëmendje nga institucioni organet drejtuese të cilat reflektojnë përmirësimet perkatese, konstatim ky që u konfirmua dhe nga studentet gjatë takimit me GVJ. <i>(Takimi me stafin akademik dhe studentet)</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Përmes analizës së syllabuseve, pothuajse të gjitha lëndët në programin e studimit përfshijnë metoda interaktive dhe diskutim gjatë orëve të mësimin, ku vend të rëndësishëm në vlerësim i jepet prezantimeve në klasë, diskutimeve, projekteve ose analizave të studimeve të rasteve, si pjesë e vlerësimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve. GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion përveç konsultimit me dokumentacionin perkatese, se sallat e leksionit janë të pajisura me logjistikën e nevojshme. Si dhe orët laboratorike praktike</p>

	organizohen në ambiente të pajisura me bazën didaktike për zhvillimin e praktikës. Biseda me studentët konfirmoi interesin e tyre për mësimin e realizuar përmes metodave interaktive. <i>(Takimi me stafin akademik dhe studentet)</i>			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Pjesë e metodave interaktive sikurse doli gjatë bisedës me stafin akademik ka qenë dhe veprimtaria e stafit akademik, i cili nxit në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve. Nëpërmjet literaturës së rekomanduar, ose artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur nxitet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit jashtë auditorit, në mënyrë të pavarur. <i>(Takimi me stafin akademik)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Praktikisht për programin “Fizioterapi” Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC, projektor dhe me sistem fonie (në rastin e sallave të leksionit). Laboratori i Fizioterapisë është i pajisur me pajisjet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Ambjentet e UET janë gjithmonë të pastra si rrjedhojë e punës shumë të mirë që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Infrastruktura në dispozicion të mësimit është përshtatur në funksion të mësimdhënies dhe është plotësisht funksionale me auditorë të pajisur me videoprojektorë dhe me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Mjediset ku zhvillohet mësimi kanë sistem funksional interneti. Institucioni kishte funksional dhe Laboratorin VR, i cili ishte siguruar në projektin e financuar nga BE me kosto 60 mijë Euro, me pajisje të avancuara teknologjike në fushën e virtual Reality. Në këtë laborator zhvillohen orë nga lënda e Anatomisë. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Prej kohësh në UET ekziston një infrastrukturë e konsoliduar IT, i gjithë stafi akademik dhe studentët kanë të drejtë të përdorin vazhdimisht instrumentet e informimit dhe kërkimit të avancuar në sistemin online të universitetit, në netëork-un e stafit akademik e studentor. Infrastruktura ofron korrespondencë elektronike, kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim online të vlerësimit përfundimtar MOODLE (UET LMS) , komunikim online pedagog-student, etj. Pjesë e rëndësishme e

	infrastrukturës IT, është biblioteka online në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Studentët njihen që në fillim të studimeve me lëndët dhe stafi akademik prezanton literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse për lëndët respektive. Studentëve në mungesë të teksteve bazë, pedagogët ju ofrojnë leksione të shtypura bazuar në artikuj e punime shkencore apo përkthime, etj. Nga biseda me studentët dhe punonjësen e Bibliotekës, GVJ krijoi bindjen se studentët shfrytëzojnë bibliotekën fizike të institucionit dhe pothuajse aspak atë online. Ata shprehen se kryesisht i sigurojnë materialet mësimore përmes platformës LMS ose i gjejnë në librarinë e Universitetit. <i>(Referuar takimeve me studentët)</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e UET duket se ka një kapacitet mesatar të botimeve, por për shkak të situatës së COVID19, vendin kryesor e zënë literaturat online me akses të hapur për studentët. GVJ konstatoi se në bibliotekë ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët, por ka pak prurje nga botimet e reja të viteve të fundit (në shqip) lidhur me programin fizioterapi. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00- 17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur. Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përfaqësuara me programin e studimit.	UET zotëron një librari dixhitale e cila mundëson aksesimin online të një numri të konsiderueshëm të librave dhe revistave shkencore në fushën e Fizioterapisë, e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët. Gjithashtu biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në nivel institucional, UET disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Çdo sallë është e pajisur me PC dhe projektor të cilat shfrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal wi-fi. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni, përveç masave të zakonshme që mundësojnë platforma online të komunikimit, gjatë 2020 aplikoi masa të jashtëzakonshme për shkak të COVID-19. Nga GVJ u konstatua se programet e nevojshme për të shërbyer për mësimdhënie në programin e studimit BA në Fizioterapi përfshin sistemin e menaxhimit të mësimit përmes platformave të ndryshme dixhitale, si platforma online UET LMS. Sipas Urdhërit administrativ për LMS, nr.09, date 02/11/2017 Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS/MICROSOFT TEAMS, personeli akademik, në kuadër

	të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimin efektiv të tij, urdhërohet vendosja në efikasitet të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, çebliq-e me material shtesë, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e ti, etj., si dhe sistemin e librarise online që është një sistem i hapur për studentët dhe pedagogët. Pedagogët raportojnë rregullisht për mbarvajtjen e mësimit online, numrin e studentëve të regjistruar, mënyrën e transmetimit të leksioneve dhe të vlerësimit të dijes.								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Përmes sistemit interaktiv online paketës Office 365, e cila mundëson 4000 adresa elektronike, të cilat aktualisht janë të mjaftueshme për mbulimin e stafit akademik dhe studentëve që janë regjistruar duke përdorur email-in zyrtar të universitetit për komunikim dhe ndërveprim online në funksion të programit. Ai është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Sipas përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e departamentit dhe në funksion të cilësisë së mësimdhënies në program, stafi akademik asiston, mbështet, udhëzon dhe mbikqyr vazhdimisht rastet e përzgjedhjes, realizimit dhe mbrojtjes së diplomave nga studentët, nëse gjatë studimeve të tyre kanë arritur mesataren e notës 8.5. Vlen të theksohet se diploma Bachelor nuk kërkon mbrojtjen e një teme diplome, por të një provimi final, sipas ndryshimeve në Ligjin 80/2015, ndonëse UET ka përcaktuar qartë rregullat për temën e diplomës <i>(Mbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10))</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura /njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore /bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësim të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore/ bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. <i>(Statuti i UET, Neni 16 (Ref. Nr. 2).</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore /bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe	Sipas Statutit të UET, Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjës për mirëfunksionimin e programeve përkatëse të studimit, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Departamenti e

<p>rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>realizon këtë përmes konsultimeve me kurrikulat ndërkombëtare, favorizuar nga fakti që një pjesë e stafit akademik janë diplomuar në universitetet evropiane dhe përvojave të sjella nga ta. Departamenti përmes aktiviteteve në auditor dhe jashtë tij, i favorizuar nga një numër i vogël i studentëve të regjistruar në programin e studimit BA në Fizioterapi, siguron një ndërveprim më të drejtpërdrejtë midis studentëve dhe pedagogëve dhe ndjekjen e ecurisë së tyre dhe vetëdijes për cilësinë e programeve të studimit që ofron. (Statuti i UET, takimi me stafin akademik).</p>			
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti dhe institucioni mbështesin format inovative të mësimdhënies duke nxitur përdorimin teknologjik, shkëmbimet profesionale, punën krijuese me projekte kërkimore, leksionet e hapura, bashkëveprimi me ekspertë, praktikantët në institucione, etj. Platformat dixhitale kontribuan në realizimin e metodave të reja të mësimdhënies / mësimnxënies.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen jo vetëm me trajnime të vazhdueshme, përfshirje në projekte, vizita studimore, etj, por institucioni ka një politikë të qartë stimuluese mbështetëse për stafin akademik në punën e tyre si kërkues shkencorë, në pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, si dhe programet e mobilitetit Erasmus. (takimi me stafin akademik, zyra e projekteve).</p>			
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>UET organizon trajnime të vazhdueshme kushtuar metodave të mësimdhënies dhe nevojave mësimore të personelit akademik, përmirësimin të aftësive mësimdhënëse dhe zbatimit të metodave bashkëkohore. UET inkurajon zhvillimin e veprimtarive kërkimore që të përgatisë akademikë dhe ekspertë me njohuri të specializuara në fushat e tyre të interesit. (takimi me stafin akademik).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar me Statut, Rregulloret dhe kontratat e punës, stafi akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve. Përmes sistemit të vlerësimit ata angazhohen edhe për përmirësimin e mësimdhënies. Nga biseda me stafin akademik, të brendshëm e të jashtëm, GVJ konstatoi pasionin e tyre për të rritur cilësinë e mësimdhënies duke u njohur me aktivitetet e tyre shkencore. (Rregullorja e programit të studimit, takimi me stafin)</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Metodat e reja në mësimdhënie dhe efektiviteti i tyre janë objekt i analizave vjetore në DIF sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik dhe drejtuesin e DIF dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit respektiv. Efektet e metodave të reja testohen edhe përmes vlerësimeve që japin studentët në fund të semestrit për çdo lëndë. (Rregullorja e programit të studimit (Ref. Nr. 7);</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret përcaktojnë qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve. Praktika e punës në institucion është konform detyrimeve ligjore lidhur me informimin e studentëve mbi metodologjinë e vlerësimit. Të gjithë studentët informohen në mënyrë të detajuar në orët orientuese. Aktet e UET janë publike dhe gjenden online për studentët, të cilët vihen në dijeni që sapo nisnin studimet Bachelor. <i>(Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.2))</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë /moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve /moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Vetë përmbajtja e detajuar dhe e strukturuar e syllabuseve sipas standardeve përcaktojnë mënyrat dhe metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore për studentët. Syllabuset respektojnë të njëjtin format dhe sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik ato prezantohen në fillim të çdo lëndë /moduli nga titullari i saj. Takimi me studentët e konfirmoi një praktikë të tillë për tri vitet e studimit. <i>(Syllabuset, takimet me stafin dhe studentet)</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, provim në mesin e sezonit, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mesim. Në përfundim të lëndës, çdo pedagog njofton studentët për vlerësimin dhe sasinë e pikëve para hyrjes në provimin final. Informimi i studentëve për rezultatet përfundimtare kryhet nëpërmjet sistemit UET LMS brenda 6 ditëve nga provimi përfundimtar. <i>(takimet me stafin dhe studentet)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në analizën e detajuar të syllabuseve të këtij programi studimi, në bisedat me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që vlerësimi i përgatitjes shkencore dhe profesionale të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Në lëndë të ndryshme të këtij programi aplikohet testimi i njohurive përmes provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar, si dhe gjatë periudhës tjetër të vitit akademik ka kontrole të vazhdueshme të njohurive shkencore dhe aftësive profesionale që lidhen me prezantime, detyra kursi, etj, në varësi nga



	natyra e lëndës dhe përmbajtja e syllabusit të tyre. <i>(takimet me stafin dhe studentet)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ u njoh nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me AADF (Albanian- American Development Foundatio) po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: “clean scoring”. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme, si në nivelin bachelor dhe master. Gjatë pandemisë së COVID19, mësimi i semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 u zhvillua online dhe pedagogët proceduan me vlerësimin e vazhduar të studentit online në platformat elektronike në Google Classroom.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës /modulit.	Programi dhe institucioni realizojnë vlerësimin me komision , i cili është i detyrueshëm vetëm për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/ provimi i përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. <i>(Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8 (Ref. Nr. 7)</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Institucioni ka siguruar anonimat e fletëve të provimeve me shkrim përmes sekretimit nga sekretarja e departamentit, gjatë kohës që provimet realizohen në auditor dhe nuk zbardhen deri sa pedagogu kryen vlerësimin e tezave. Ndërsa nga semestri i dytë i vitit 2020, në kushtet e pandemisë së COVID19, gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik , GVJ u informua se provimet organizohen online nga pedagogu i lëndës dhe asistenti i tij/ saj sipas sistemit elektronik UET LMS /MICROSOFT TEAMS në pamundësi për tu bërë kodifikimin për çdo student, sepse çdo student ngarkonte në sistemin LMS dhe/ ose TEAMS zgjidhjen e provimit dhe ishin të identifikueshem me emer. <i>(takimet me stafin dhe studentet)</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përgjatë vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në varësi nga natyra e lëndës, pas çdo provimi stafi përgjegjës akademik jep komentet dhe sugjerimet lidhur me përmirësimet të ndryshme të procesit të të nxënës nga studenti. Sistemi elektronik LMS i jep mundësi pedagogut të jetë transparent në mënyrë që studenti të jetë më i qartë në vlerësimin që ka marrë, bashkangjitur me notën e provimit, pedagogu bën komentet e tij /saj, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. <i>Manuali i sistemit UMS gjendet në Dok. nr.46</i>
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk	Sipas akteve rregullatore të institucionit çdo rast i dyshuar kopjimi në provime trajtohet si shkelje e rregullave të cilat përcaktohen qartë edhe në Rregulloren e programit të studimit Fizioterapi ku specifikohen procedurat e vlerësimit të studentëve, ku në rastet e kopjimit studenti konsiderohet mbetës.

tolerohen nga personeli akademik.	<i>Dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6. (Ref. Nr. 7.1)</i>			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Provimet dhe testimet me studentët bazohen në kontrollin e dijeve dhe rezultatet e tyre hidhen në sistemin elektronik LMS brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 6 ditëve kur provimi është me shkrim. Hedhja në sistem garanton transparencë dhe siguri, si dhe respekton të dhënat personale. Procedurat janë të parashikuara në aktet rregullatore të institucionit dhe të programit të studimit BA në Fizioterapi. <i>(Rregullore e UET, neni 27 (Ref. Nr. 5))</i>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga sekretarja mësimore ku studentet kane akses të plotë të njihen me rezultatet individuale. Pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në seancën sqaruese me pedagogun e lëndës, e cila zhvillohet brenda dy javëve nga data e provimit. Sipas Rregullores së programit të studimit BA në Fizioterapi, studentët mund të apelojnë rezultatin e një provimi përfundimtar apo komponentëve të tjerë të vlerësimit përmes kërkesës në Departament <i>(referuar dokumentit nr. 7 Rregullore e programit të studimit, Pika 5.8. Kërkesa për rivlerësim).</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Rregulloret e UET, dhe DIF parashikojnë aktet e verifikimit dhe vendimmarrjes pas ankesës së studentëve. Komisioni vlerësues i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë. Dekani pasi shqyrton kërkesën e studentit vendos, në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studenti nëse ka të drejtë, të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat. <i>(Referuar takimeve fizike në institucion)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit ofron njohuri dhe aftësi të përshkruara në detaje në syllabuset dhe dokumentacionit shoqërues të programit si Plani Strategjik Për Zhvillimin e Programit Bachelor Fizioterapi dhe Rregulloren e programit të studimit Fizioterapi për tre vitet akademike të fundit. Referuar programit të studimit dhe diskutimeve me stafin akademik, GVJ vlerëson se ky program zhvillohet në mënyrë të tillë që synon formimin e specialistëve në fushën e rehabilitimit fizioterapeutik dhe garanton rritjen e njohurive nga njëri semestër në tjetrin, nga viti i parë me njohuri hyrëse në këto fusha të cilat thellohen në vitin e dytë dhe të tretë. Studentët kanë mundësi të marrin njohuri të thelluara dhe njëkohësisht të zhvillojnë aftësinë profesionale, jo vetëm nga programi BA në Fizioterapi, por edhe

	<p>në varësi nga pasioni, angazhimi dhe angazhime të tjera plotësuese sikurse u reflektua nga studentët që aktualisht edhe punonin si vullnetarë apo me kohë të pjesshme në institucionet e shëndetit apo klinika private.</p> <p><i>(Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - BA Fizioterap)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Sipas të dhënave të programit, Plani mësimor i ndarë sipas Vepërimitarive Formuese (A-E) garanton zhvillimin e aftësive në Terminologji Mjekësore (Lëndë Plotësuese D) me 4 ECTS; lëndë e tipit "D" që në këtë program është lëndë e gjuhëve të huaja Anglisht me 5 ECTS dhe praktikat klinike I&II me 8 ECTS secila. Krahas tyre studentët marrin edhe njohuri në fushën e Psikologjisë me 6 ECTS, Hyrje në Filozofi me 6 ECTS si lëndë të tipit A si dhe Metoda Kërkimore me 4 ECTS po si lëndë të tipit A(Lëndë Bazë). Në funksion të inkurajimit të diskutimit të ndërsjelltë midis studentëve dhe aftësimit për të punuar në grup, një rol luan edhe Praktika Klinike I&II me 8 ECTS, lëndë plotësuese e tipit D.</p> <p><i>(Tabelat Përmbledhese, Tabela 9, Dok. Nr. 14.4).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Çdo anëtar i stafit akademik në fund të semestrit analizon edhe ecurinë e lëndës, rezultatet e arritura dhe parashikon ndërhyrje përmirësuese në varësi edhe nga rezultatet dhe sugjerimet e studentëve, sikurse doli nga biseda e GVJ me stafin akademik dhe përgjegjës të DIF. Në përfundim të lëndës/ modulit studentët zhvillojnë një detyrë kurse sikurse paraqitet në syllabusin e lëndëve, në të cilën prezantojnë njohuritë e mara, si dhe kompetencat e fituara. Në përfundim të prezantimeve pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë dhe kompetencat e fituara. <i>(Takimet në institucion).</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Nga diskutimet me stafin akademik rezultoi se në përfundim të çdo moduli dhe semestri, stafi akademik informon studentët mbi gjetjet kryesore dhe vlerësimet e lëndës/ modulit. Përmes kësaj forme pedagogu përmbledh dhe diskuton me studentët si të përmirësojnë marrjen e njohurive, metodologjinë e përdorur dhe aspekte të tjera të rëndësishme për kursin.</p> <p><i>(Takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas të dhënave të institucionit dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik rezultoi se ai është vazhdimisht i angazhuar në aktivitete shkencore jashtë programit të studimit. Pjesa e konsiderueshme e stafit ishte pjesë e projekteve e angazhimeve dytësore profesionale. Stafi akademik i kushton vëmendje realizimit të orëve të hapura, ku trajtohen dimensione të ndryshme dhe aktualiteti mbi zhvillimin e Fizioterapisë si disiplinë mjekësore, apo të seminareve ku studentët e shkëlqyer të programit BA në Fizioterapi kanë qenë pjesë e prezantimeve dhe debateve .</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Konstatohet se kemi një gërshetim të njohurive teorike me ato praktike, përmes ushtrimeve dhe detyrave, e cila për vetë natyrën e programit BA në Fizioterapi, është adekuate pasi studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Për të arritur këtë objektiv, në secilën lëndë të programit është parashikuar të zhvillohet një detyrë kurse, e cila ka 20% të vlerësimit përfundimtar. Sipas konfirmimeve gjatë takimeve në institucion, lëndë të caktuara të programit Bachelor në Fizioterapi zhvillohen në laboratorët e fizioterapisë, ku studentët e këtij programi,</p>

	<p>njohuritë teorike të marra gjatë leksioneve kanë mundësi t'i zbatojnë nga ana praktike. Gjithashtu, realizimi i praktikave klinike në ambiente spitalore, të ndarë në pavione të ndryshme sipas programit të studimit, mundëson rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës. <i>(Takimet ne institucion)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ konfirmon se puna në grup nxitet edhe nga fakti se një pjesë e madhe e lëndëve trajtojnë tematika e çështje të përafërta dhe plotësuese me njëra tjetrën, për të cilat ka disa anëtarë të stafit akademik të kualifikuar. Nisur nga sa më sipër, personeli akademik i UET mbështet dinamikën e punës në grup për zgjidhjen e problematikave të caktuara. <i>(Takimet ne institucion)</i></p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Stafi akademik dhe departamenti inkurajojnë studentët të zhvillojnë ide inovative në detyra të projektit, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Statusi i UET garanton shprehjen e lirë të ideve dhe i siguron personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim. <i>(Takimet ne institucion)</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Stafi akademik promovon përfshirjen e studentëve të BA Fizioterapi në projektet e kërkimit shkencor që financohen nga donatorë të ndryshëm. Sipas "Strategjisë së Kërkimit Shkencor; Vizioni, pika 1.2", kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. <i>(Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020 (Ref. Nr. 3.1); Strategjia e kërkimit Shkencor 2021-2025 (Ref. Nr. 3.2)</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Departamenti ka prioritet angazhimin profesional në network-e dhe në programe shkëmbimi me universitete të tjera evropiane dhe të Ballkanit, në funksion të nxitjes së mobilitetit në kuadër të projekteve Erasmus + KA1, mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UET, dhe mund të përhapen edhe tek kolegët e tjerë në institucion. Kështu diferencat që mund të ekzistojnë me universitetet jashtë ngushtohen dhe mobiliteti i studentëve dhe përshtatja e tyre me mjedisin e institucioneve pritëse bëhet me e lehtë, pasi ata hasin praktika të ngjashme me çfarë kanë përjetuar gjatë studimeve në UET. Drejtuesit e Institucionit dhe stafi i DIF ofruan të dhëna konkrete të shkëmbimeve të stafit akademik në universitetet e vëndeve të BE duke besuar që edhe studentët e këtij programi relativisht të ri të kenë mundësi në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Rregullat dhe procedurat për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës gjenden në <i>Dokumentin B.II</i> . Për punimin e diplomës, jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet që nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, deri tek procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. (<i>Mbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10)</i>)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në funksion të asistimit të studentëve dhe transparencës koordinatori i programit të studimit shpërndan listën e pyetjeve e cila hartohet nga Departamenti dhe shpallet për studentët brenda datës 31 Mars të çdo viti akademik Në rastin e diplomës, çdo pedagog që caktohet udhëheqës i temës së diplomës punon me studentin me anë të seancave metodologjike për t'i orientuar gjatë punimit të saj. (<i>Rregullore UET, neni 39 pika 2 (Ref. Nr. 5)</i>) (<i>Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.3 (Ref. Nr. 7.2)</i>)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Përmbajtja e programit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) bazohet në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të parë: 20% lëndë nga Kategoria A, 70% lëndë nga Kategoria B, dhe 10% lëndë nga Kategoria C. Gjithashtu, Teza e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar ndërtohet sipas formatit të posaçëm [<i>formati A.IV.2.4</i>], ku rubrikat e vlerësimit janë të orientuara drejt pyetjeve cilësore dhe me zhvillim. (<i>Formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar A.IV.2.4 (Ref. 10.2)</i>)
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Studentët, pasi njihen me fondin e pyetjeve dhe manualin e kërkimit shkencor, u ofrohet asistencë e gjerë nga stafi akademik për sqarimin dhe saktësimin e detajeve të programit, apo u ofrohen konsultime dhe ju vihen në dispozicion materiale shtesë në funksion të përgatitjes së tyre për provimin e formimit apo temen e diplomës. Tema e diplomës regjistrohet me një udhëheqës shkencor që është caktuar pedagogu i fushës përkatëse dhe për formatet e kërkimit shkencor UET ka përgatitur një Manual të detajuar që ju vjen në ndihmë studentëve. (<i>Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës, pika B.II.5.2 (Ref. Nr. 10)</i>)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në varësi nga natyra, tematika dhe rastet studimore, institucioni vendos infrastrukturën shkencore në dispozicion të studentit për të kryer matjet e nevojshme dhe për të arritur objektivat dhe fushën e studimit. Për të krijuar mundësi optimale për kryerjen e studimeve empirike, UET i orienton studentet dhe mbikqyr punën e tyre në institucionet që ka marrëveshje bashkëpunimi.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e	Bazuar në praktikat e konsoliduara akademike të institucionit, udhëheqësi i diplomës/ tezës është përgjegjës për të asistuar dhe udhëhequr studentin gjatë

<p>rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>gjithë fazës deri në mbrojtjen e saj. Seancat metodologjike, duhet të trajtojnë çështje të tilla nën kujdesin e pedagogut udhëheqës :</p> <p>a) Trajtimin e aspekteve metodologjike;</p> <p>b) Përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj);</p> <p>c) Punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave</p> <p>d) Hartimin e punimit të diplomës etj.</p> <p>Udhëheqësi i diplomës, garanton cilësinë e rezultateve të punimit, pasi studentët nuk mund të dorëzojnë punimin e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit. (Rregullore UET, neni 39,pika 3 (Ref.Nr.5) ; (Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës, pika B.II.5.2(Ref.Nr.10)</p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi i formimit mbrohet përpara një komisioni të përbërë nga 5 ose 7 anëtarë, që përfaqësojnë fushat kryesore të studimit të përcaktuara në fondin e pyetjeve të provimit. Sipas praktikës, studenti merr notën në përfundim të provimit final ose temës së diplomës. Nota është mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i Komisionit dhe procesverbali firmoset nga të gjithë ata.</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kohëzgjatja e lëshimit të diplomës është brenda 6 (gjashtë) muajve. Deri në momentin e pajisjes me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave. (Rregullore UET, neni 40, pika 40.1(Ref.Nr.5)</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sekretaria Mësimore ju ve në dispozicion studentëve sipas rregullave administrative në çdo rast që kërkohen prej tyre, kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit edhe pas përfundimit të studimeve. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). (Ref. Nr. 15)</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/ konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në aktet ligjore dhe në dokumentet rregullatore të institucionit, Rregullores së Sekretarisë mësimore në UET regjistri i lëshimit të diplomave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat. Sekretaria ruan kopjen e njësuar me origjinalin për një kohë të pacaktuar. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. (Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore)</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>
<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor- shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konkludon se institucioni ka ngritur dhe ka funksionale strukturën përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit “Fizioterapi” e cila është Zyra e Burimeve Njerëzore. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, përcaktohen midis të tjerash llojin e dokumentacionit (në formë shkresore dhe/ apo elektronike) që mbahet pranë institucionit dhe personin përgjegjës. Në lidhje me dokumentat që përmban dosja specifike e stafit akademik dhe administrative, institucioni vepron në bazë të udhëzimit për përmbajtjen e dosjes së stafit.</p> <p><i>Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)</i> <i>Format Dosje Staf Akademik (ref. Nr. 44.1; 44.2)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita online, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, statutin dhe rregulloren e rekrutimeve të UET.</p> <p><i>Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Përditësimi i të dhënave kryhet çdo vit akademik dhe janë të hapura, me konkurs dhe synojnë përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zoterojnë grada shkencore. Institucioni disponon udhëzime dhe dokumenta të hartuar që provojnë procedurat dhe kriteret për rekrutimin e personelit. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit https://uet.edu.al/rreth-uet/rretetsociale. (<i>Shembull thirrje për staf akademik (Ref. Nr. 11.1)</i>) dhe në gazetën Liberale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web të UET (si edhe në rrjetet sociale të UET) dhe janë në përputhje me kërkesat dhe specifikat të programit të studimit. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore.</p> <p><i>Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 22 (Ref. Nr. 5);</i></p>

përmbajtjen e programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit "Fizioterapi". Dokumenti i vënë në dispozicion nga institucioni, tregon se stafi akademik në përgjithësi ka një ngarkesë mësimore që është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, e cila është e përshtatshme dhe mund të realizohet prej tyre në mënyrë profesionale. <i>(Aneks Tabela 4 e ngarkesës në të gjitha programet e studimit e stafit akademik të angazhuar)</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UET për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. Personelit akademik u ofrohej mundësia e publikimit pa kosto në revistën që boton FSHMT, pjesmarrja pa kosto në të gjitha konferencat që organizon vetë UET. Ndërkohë, gjatë këtij takimi stafi akademik dëshmoi edhe për mbështetjen financiare të marrë për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë institucionit kur ata i kishin bërë kërkesë këtij të fundit.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor- shkencor.	GVJ konkludon se ka përpjekje dhe aktivitete të zhvilluara në funksion të kualifikimit dhe zhvillimit të stafit, trajnimit mbi metoda inovative dhe dëshmon për pjesëmarrje në aktivitete dhe konferenca të ndryshme. Në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet ndahen në katër grupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike. Gjithashtu, kryhen trajnime nga Zyra e TIK, për përdorimin e sistemit LMS, për pedagogët, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimit më efektiv të tij. <i>(Video-trajnime mbi sistemin Teams/LMS (Ref. Nr. 46.4))</i>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të	GVJ konkludon si nga dokumentacioni i dorëzuar ashtu dhe gjatë takimit se ka përpjekje maksimale nga institucioni për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. <i>(Takimi me burimet njerëzore)</i>

programeve të studimeve të ciklit të parë.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Godinat në të cilën zhvillohen aktivitetet mësimore dhe të tjera, të këtij programi studimi është e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program. Dokumenti i vënë në dispozicion nga Institucioni pasqyron të dhënat infrastrukturore në funksion të programit të studimit. Ambjentet janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në orarin 8.00-16.00. Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur edhe mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës. (Ref. Nr. 42; Ref. Nr. 42.1)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se hapsirat e nevojshme në funksion të programit të studimit "Fizioterapi" janë salla seminaresh, leksionesh, laboratorë dhe biblioteka. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë në sipërfaqe optimale dhe bashkëkohore. Ato janë të pajisura me kompjuter dhe videoprojektor për të lehtësuar procesin mësimor.</p> <p><i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42; Ref. Nr. 42.1)</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konkludon se institucioni disponon mjediset e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit specifik. Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Në sallat e pajisura me mjete audio visive u mundësohet studentëve paraqitja e materialeve të ndryshme dhe dokumentacioneve të cilat do të hasin gjatë praktikës së punës, u demonstron si bëhen teste të ndryshme, etj. UET ka aktualisht në përdorim 7 laboratorë mësimorë informatike të cilët janë në dispozicion edhe për programin e studimit BA Fizioterapi dhe mjaftueshëm salla mësimore për zhvillimin e procesit akademik (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio</p>

	vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. <i>(vizita ne institucion)</i>			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni konkludojmë se FSHMT disponon 3 laboratorë të anatomise, infermierisë dhe fizioterapisë për këtë program studimi me 25 vende pune aktive. Studentët mund të punojnë si në laborator, ashtu edhe në bibliotekë për realizimin e detyrave të kursit. <i>(vizita ne institucion)</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Praktikat mësimore realizohen në institucionet private ose publike me të cilët UET ka marrëveshje. Studentët mund të diskutojnë me tutorin e praktikave mësimore, apo pedagogë të tjerë të programit të studimit, për orët e praktikës. (400-orë në total- 200 orë për vitin e dytë dhe 200 orë për vitin e tretë) janë të programuara që të zhvillohen në vendin e praktikës. <i>Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale (Ref.Nr.32); Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34.1 – 34.8); Dokumentimi B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni dhe vizitës online, GVJ konstatoi se FSHMT vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti një sallë bibliotekë në godinën A, një bibliotekë me sipërfaqe 40 m2 me 41 vende leximi , si dhe një ambient tjetër leximi me sipërfaqe 300m2, ku ndodhet fondi i librave të bibliotekës. Biblioteka është e paisur edhe me PC , që studentët të aksesojnë bibliotekën on-line SAGE dhe EBSCO , në të cilat është abonuar institucioni, për libra të ndryshëm që ju nevojiten studentëve dhe stafit akademik <i>Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës _Infrastruktura; (Ref. Nr. 42; Ref. Nr. 42.1)</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga takimi online me përfaqësues të institucionit konkludojë se në dispozicion të bibliotekës ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodik, CD dhe harta), në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Aksesit i literaturës së programit nga studentët, garantohet nëpërmjet: 1. Literaturës fizike në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti. Stafi akademik parashtron kërkesën për blerjen e literaturës nëpërmjet plotësimit të formatit përkatës 2. Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia

specifikës së programit të studimit.	3. Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj; 4. Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin UET LMS. (Ref. Nr. 45); (Ref. Nr. 42; Ref. Nr. 42.1) Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13) Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës dhe nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultoi se Institucioni ofron abonimin në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. (vizita ne institucion)			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga vizita në këtë bibliotekë online rezultoi se ajo është e pajisur me pajisjet kompjuterike me qëllim kryesor aksesimin e shpejtë të bibliotekave online. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS. Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimi në institucion konkludon se ka përpjekje nga institucioni për shtimin e zërave të bibliotekës. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, janë të përcaktuara edhe në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit. Në këto institucione ku studentët realizojnë praktikën mësimore, shfrytëzojnë të gjithë burimet e tyre logjistike dhe jo vetëm, për të rritur praktikitetin e tyre. (Ref. Nr. 45.2; 45.1; 45.3);			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët nga e Hëne- Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. Informimi i studentëve mbi oraret e funksionimit të bibliotekës bëhet dhe me anë të njoftimit në mjediset e institucionit. (Vizita ne biblioteke)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UET përdor si sistem të menaxhimit të brendshëm një sistem të quajtur UMIS (Ref. Nr. 46). Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, së bashku me rezultatet e provimeve ndër vite. Gjatë takimeve me studentët ata u shprehën se e shohin sistemin mjaft praktik dhe funksional. <i>Manual i përdoruesit të sistemit UMIS (Ref. Nr. 46)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit, UMIS administrojnë informacione dhe dokumentacion për të gjithë të angazhuarit në këtë program studimi. Pedagogët e aksesojnë sistemin duke regjistruar hap pas hapi vlerësimet e studentëve. Sistemi shfaq siguri pasi veprimet janë të gjurmueshme.</p> <p>Sistemi shërben edhe për të ngarkuar elektronikisht regjistrat e pedagogëve si dhe ngarkesën e tyre mësimore. Fizikisht regjistrat arkivohen në Departamentin e Infermierise dhe Fizioterapisë.</p> <p><i>(Manual i përdoruesit të sistemit UMIS) (Ref. Nr. 46)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, stafi akademik dhe stafi administrativ; stafi administrativ luan një rol kyç në përditësimin dhe hedhjen e vazhdueshme të të dhënave. Stafi akademik gjithashtu ka akses të dedikuar për menxhimin e lëndëve të zhvilluara dhe komponentëve të vlerësimit total të studentëve. UET në kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka vënë në përdorim platformën UET LMS (Learning Management System), duke filluar nga viti akademik 2016-2017. UET LMS është standardi më bashkëkohor i përdorur nga gjithë universitetet prestigjioze në botë në informatizimin e procesit të mësimdhënies online. Aktualisht, sistemi UET LMS është azhurnuar më të gjithë informacionin bazë si: Janë regjistruar të gjithë studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; <i>(Manual i përdoruesit të sistemit UMIS)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi ju dërgohen kryesisht përmes adresave të unifikuara të e-mailit. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe komunikimit është shumë efektiv dhe në adresimin e problematikave të ndryshme të studentëve dhe pedagogëve gjithashtu.</p> <p><i>(Takimi me studentet)</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë</p>	<p>Platforma LMS është edhe një mjet eficient në dispozicion të KSBC-së, por jo vetëm, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të</p>

reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Në përfundim të çdo semestri nxirren statistikat përkatëse për çdo pedagog në lidhje me përdorimin e LMS-së. (<i>Takimet ne Institucion</i>)								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuara nga institucioni dhe nga kqyrja e faqes zyrtare web të UET, konkludon që informacioni që lidhet me këtë program studimi, programet e lëndëve, të dhënat rreth personelit akademik dhe aktivitete të ndryshme që zhvillohen publikohen në faqen e internetit " http://www.uet.edu.al/ " në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të gjithë elementët e mësipërm në terma të detajuar janë të publikuara në gjuhën shqipe, ndërsa në terma më të përgjithshëm janë publikuar në gjuhën angleze (<i>Ref. Nr. 48</i>). Përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, shërbejnë gjithashtu, si një mjet komunikimi për të publikuar aktivitetet që zhvillohen në UET. UET ka ndërtuar faqen e re e cila është në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Njësitë përbërëse të UET dhe departamenteve të tij, hartojnë projekt buxhetin në muajin tetor të çdo viti dhe për zbatimin e këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku percaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. (<i>Pasqyrat financiare me shënime (Ref. Nr. 50.1 – 50.3); Raportet e auditimit (Ref.Nr. 50.4 – 50.6)</i>)
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet	Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Nuk konstatohet që të hartohet plan financimi i posatshtëm për programin e studimit. (<i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 18.1;18.2</i>)

<p>financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare.</p> <p>Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (<i>Raportet e auditimit (Ref.Nr. 50.4 – 50.6).</i>) (<i>Pasqyrat financiare me shënime (Ref. Nr. 50.1 – 50.3).</i>)</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga takimi me instancat administrative në UET u evidentua se ka raport auditiv çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët. (<i>Raportet e auditimit (Ref.Nr. 50.4 – 50.6).</i>)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Nga aneks tabelat përmbledhëse mbi raportimet financiare vihet re se aftësitë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. (<i>Raportet e auditimit (Ref.Nr. 50.4 – 50.6).</i>) (<i>Pasqyrat financiare me shënime (Ref. Nr. 50.1 – 50.3).</i>)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga Universiteti European i Tiranës vëren se pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet bëhet në përputhje me kriteret e pranimin dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga statuti i Universitetit, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit 80/2015. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ato janë të parashikuara në nenin 48 të rregullores se organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore si dhe gjenden të publikuara në faqen elektronike të IAL. Kandidati duhet të këtë përfunduar Maturën shtetërore në vend ose e njëvlefshme me të. Diploma duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse e MASR dhe të plotësojë kriterin e meritës. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. <i>(Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve (Ref. Nr. 27.1)</i>
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Kjo gjë pasqyrohet edhe në Rregulloren e Universitetit European të Tiranës , neni 31 mbi procedurat dhe kriteret e pranimin në Ciklin e Parë të Studimeve. Aty përcaktohen rregulla të qarta, të barabarta dhe të njëjta që garantojnë të drejta identike për çdo student në këtë program studimi, që nga faza e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve të tij. <i>(Rregullore UET, neni 31 (Ref. Nr. 5)</i>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimin e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se UET kriteret, procedurat e pranimin e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit bëhen publike përmes faqes web të universitetit si dhe në rregulloren e këtij programi studimi gjithashtu dhe në përputhje me rregullat e vendosura nga ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë, i dërgon në MASR. Po ashtu çdo person i interesuar mund të drejtohet dhe fizikisht pranë Zyres së Këshillimit Studentor dhe të Departamentit të Infermierisë dhe Fiziotherapisë për të marrë të gjithë informacionet në mënyrë të detajuar.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni ka një praktikë të miratimit të kriterëve të pranimin ku specifikohen lista e kriterëve për llogaritjen e pikëve të kandidatëve në programet e studimit të FSHMT. Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukture dhe akademike të UET-it dhe sipas kriterëve specifike që mund të propozohen nga Departamenti dhe

	miratohen në Senatën Akademik. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve. <i>(Takimet në institucion)</i>			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni konkludon se UET propozon mënyrën e pranimeve për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, dhe se Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësisë bazë, në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon IAL përkatëse, përcakton detyrimet që do të ketë studenti nëse pranohet në atë program, sipas planit mësimor në fuqi, si dhe njohjes dhe shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Studimet në FSHMT mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërorë si dhe nga çdo shtetas i huaj i cili ka njohuri të gjuhës shqipe. <i>(Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28)</i>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën se Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ligjit të arsimit të lartë, propozon përpara çdo viti akademik numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë. GVJ bazuar në bisedat dhenë dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën gjithashtu se Universiteti Europian i Tiranës, në fillim të vitit akademik dhe në vijimësi, në bashkëpunim me stafin akademik të FSHMT, Zyres së Karrierës dhe Zyres së Marketingut (PR) përgatit dhe shpërndan materiale për publikun në lidhje me programet e studimit që ofron, zhvillon seanca të hapura me maturanët ku shpjegohen dhe orientohen një pjesë e elementeve që shoqërojnë veprimtarinë akademike. <i>(Politika e marketingut të programit të studimit (Ref. Nr. 51) Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online (Ref. Nr. 48)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të ëb si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit (Pika 5.6 e Rregullores së programit: Kalimi në vitin pasardhës) dhe aktet e tjera rregullatore. Në rregullore është e përcaktuar se:

<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>5.6. Kalimi në vitin pasardhës</p> <p>5.6.1 Pas sezonit të riprovimeve, ka të drejtë të vazhdojë studimet në vitin pasardhës, studenti i vitit të parë që rezulton me të paktën 30 (tridhjetë) kredite dhe studenti i vitit të dytë me të paktën 60 (gjashtëdhjetë) kredite.</p> <p>5.6.2 Në rast se studenti, pas sezonit të riprovimeve në shtator, nuk ka fituar kreditet e nevojshme për të kaluar në vitin pasardhës, sipas pikës më sipër, shpallet “përsëritës”. Ai duhet të ri frekuentojë përsëri lëndët, në të cilat nuk është kualifikuar, kundrejt pagesës së një tarife përkatëse. Studenti ka të drejtë të frekuentojë edhe lëndët në të cilat nuk ka vlerësim kalues.</p> <p>Referuar rregullores mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, edhe në këtë dokument përshkruhen procedurat përkatëse dhe parashikimet për regjistrimin përfundimtar në program për studentët që regjistrohen me transferim/mobilitetet. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, përgatitja e punimit të diplomës, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave që shpërndan IAL në shkollat në takimet me maturantët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturën, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj.</p> <p><i>Komunikimi i integruar i marketingut (Ref. Nr. 51);</i> <i>Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online (Ref. Nr. 48)</i> <i>Rregullore mësimore BA Fizioterapi (Ref. Nr. 7)</i> <i>Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetet (Ref. Nr. 28)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të UET si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ndek procedurat në lidhje me transferimin e studimeve në përputhje dhe me bazën ligjore në fuqi (udhëzimi i MARS, nr. 17 datë 30.07.2019). Studentët informohen në lidhje me transferimin e studimeve, kur është e mundur, njohjen e kualifikimeve apo studimeve te pjeshme të realizuara në një institucion tjetër të arsimit të lartë. Gjithashtu mundësohet informacioni në lidhje me procesin e ekuivalentimit të studimeve, me universitetet e tjera jashtë vendit. Kriteret e transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit sanksionohen qartë në rregulloren e UET. Po ashtu institucioni ka vënë në dispozicion dhe tabelën</p>

	e transferimeve të studentëve prej dhe nga programi i studimit. <i>(Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28)</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga vizita e GVJ në institucion si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga UET, GVJ konstaton se, përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në silabusin e lëndës. Silabuset janë në dispozicion të studentëve në të gjitha format, si elektronikisht, përmes sistemit LMS, faqes së web, ashtu edhe fizikisht në Departament përmes sekretarisë mësimore. Studentët pohojnë se njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejtëpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur njihen me lëndën dhe në vazhdimësi.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Sipas Rregullores së programit të studimit, DIF ka miratuar kriteret që duhen plotësuar për të shkuar drejtë provimit të formimit apo mbrojtjes së punimit të diplomës. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen . Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu studentët njoftohen nëpërmjet e-mailit për çdo veprimtari akademike, nga koordinatoret e Departamenteve. <i>(Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10) Kalendari akademik (Ref. Nr. 10.1; 10.2; 10.3; 10.4)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ, konkludon se, UET dhe FSHMT ofron informacione në mënyrë periodike të organizuara në paraqitje të ndryshme, si gjatë tureve informuese në gjimnaze ashtu edhe gjatë vizitave në ambjentet e Universitetet. Gjithashtu UET zhvillon Open Days ku maturantët mund të vizitojnë nga afër institucionin e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi, si edhe Javën e Orientimit për studentët e rinj, përpara fillimit të vitit akademik. Përgjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh sipas fakulteteve. Ata japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UET. Mbledhjet e hapura të departamenteve shërbejnë gjithashtu për informimin dhe diskutimin me studentët lidhur me programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të UET, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit; • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit; • Rregullores mësimore të programit të studimit; • Kontratës që nënshkruhet me UET në momentin e regjistrimit. <p><i>(Takimet ne institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni informon studentët në mënyrë të hollësishme për trukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Fizioterapi. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it. Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme edhe nëpërmjet LMS. Për studentët e vitit të dytë, marrin sërish informacion në momentin e përzgjedhjes së lëndës, nga pedagogu përgjegjës për këtë proces.</p> <p><i>(Rregullorja programit të studimit BA Fizioterapi (Ref. Nr. 7)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të UET, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij. Fakulteti zhvillon vazhdimisht takime, aktivitete dhe orë të hapura me përfaqësues të instituconeve të cilat ofrojnë mundësi punësimi. Studentët shpesh janë pjesë e këtyre takimeve dhe informohen përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit pranë UET, për mundësitë e reja ku ta mund të aplikojnë. Studentët shprehen se Panairi vjetor i punës, u vjen shumë në ndihmë, për identifikimin e varianteve të reja të punësimit sipas profilit të tyre të studimit. Bordeve të tregut të punës – të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. <i>(Bordi i Tregut të Punës 2018-2019 (Ref. Nr. 12.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të UET dhe FSHMT, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet web-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, numrin e lëndëve për çdo semestër, fillimin e mbarimin e semestrave, sezonin e provimeve, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjithashtu edhe biblioteka funksion dhe ofron kushte cilësore dhe një fond</p>

	të mjaftueshëm botimesh hard copy dhe elektronikisht, shqip dhe anglisht kryesisht pa përjashtuar edhe gjuhët e tjera të mundshme të botimeve. Stafit IT së UET, ndihmon studentët me informacion mbi mënyrat dhe oraret e përdorimit të Bibliotekës.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Nga takimi me studentët GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi u mundësohen studentëve në momentin e regjistrimit të tyre, pajisen nga Zyra e IT, me një adresë e-maili të UET. Kjo u mundëson studentëve që të marrin të gjitha informacionet që dërgohen nga koordinatori dhe departamenti dhe jo vetëm. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit LMS, studentët edhe pse mund të jenë në distancë, mund të marrin njoftimet e pedagogut të lëndës, orarin mësimor të personalizuar; njoftimet në nivel universiteti për të gjithë studentët; mundësi komunikimi me mesazhe, chat-e me pedagogët etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të regjistruar në programin e studimit për çdo vit akademik, si dhe për numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit në IAL. <i>(Cilësia në hyrje dhe dalje BA Fizioterapi (Ref. Nr. 27); Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre (Ref. Nr. 29)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon nga ana e UET bëhet kujdes për dokumentacionin që pasqyron çdo vit numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Informacioni disponohet nga Sekretaria mësimore, i pasqyruar në Regjistrin Themeltar, që tregon regjistrimet, pezullimet apo dhe ndërprerjet e studimeve. Regjistri ruhet fizikisht dhe elektronikisht për një periudhë kohore të pacaktuar. <i>Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)</i>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se sekretaria mësimore ka përgjegjësinë dhe disponon në regjistër përkatës të gjitha të dhënat e studentëve nga pranimi deri në diplomim. <i>(Takimi në sekretarinë mësimore)</i>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni përdor Sistemin UMIS, ku çdo

përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	student është i pajisur me username dhe passëord unik, duke i mundësuar kështu shërbimet e sekretarisë mësimore, pa frekuentuar ambientet fizike të Sekretarise në Universitet. Kështu gjurmohen edhe studentët aktivë, gjatë ciklit normal të studimeve. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS. Aksesit në hedhjen e të dhënave statistikore është i dedikuar vetëm për sekretarinë mesimore, dhe shfaq elementë të lartë mbrojtje nga ndërhyrjet.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, u konstatua se DIF, harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Informacioni transmetohet vit pas viti deri në diplomimin e studentëve dhe ruhet në Zyren e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. <i>Analiza e departamentit për programin (Ref. Nr. 38)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se, UET ka parashikuar në organizimin dhe funksionimin e tij pjesëmarrjen e studentëve. Në Statutin e UET është e përcaktuar që dy anëtarë të Senatit Akademik janë studentëNdër strukturat kryesore përmendim: <ul style="list-style-type: none">• Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.• Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.• Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.• KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.• Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët. Studentët përfshihen edhe në procese të tjera vendimmarrëse, si dhe përfaqësohen në Komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe në Këshillin e Etikës. <i>(Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51 (Ref. Nr. 2)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	Në Statutin e IAL është e përcaktuar që një prej anëtarëve të NJSBC-së është anëtar i Këshillit Studentor. Po kështu, edhe në grupin e brendshëm të vlerësimit (GVB), në kuadër të procesit të akreditimit njeri prej anëtarëve është student. Një mënyrë tjetër janë dhe “Focus Group”-et , me


<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>grupe studentësh të programeve përkatëse, për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre. Gjithashtu, vetë Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë e studentë për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave përpërmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit BA Fizioterapi është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti. <i>(Statuti UET)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB, arrijmë në konkluzionin se, FSHMT, ofron mundësinë e transferimit të studimeve. Transferimet pranohen në fillim të çdo vit akademik, jo më vonë se java e pestë e semestrit të parë. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit të shlyera në institucionet e tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, njihen dhe njehsohen, në një program të njejtë ose të ngjashëm studimi. Procesi i transferimit të studimeve është i rregullt dhe me procedurë të përcaktuara qartë në rregullore. Vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve e merr Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë Bazë. <i>(Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve, (Ref. Nr. 28)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon siç u shprehem edhe më sipër, në UET garantohej përfshirja e studentëve në procese të ndryshme vendimmarrëse apo të tjera, gjë që realizohet edhe në rastin e rishikimit për përmirësim të programit. <i>(Referuar RVB dhe vizitës në institucion)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se personeli akademik e ka në vëmendje barazinë dhe meritokracinë e studentit në vlerësim dhe në mënyrë hierarkike shqyrtohet çdo ankimim. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët


<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës me institucionin GVJ konkludon se në Universitetin Europian te Tiranës funksionon Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. <i>(Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik (Ref. Nr. 27.2)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës me institucionin vihet re se veprimtaria e Zyres së Këshillimit të Karrierës orientohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre paraqet, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj <i>(RVB, takimet në Institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion Zyra për Këshillimin e Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Detyrat dhe funksionimi i Zyres së Këshillimit të Karrierës në Universiteti Europian te Tiranës është që ndërmjetësojë dhe të japë informacion në lidhje me bursa, trajnime, shkëmbime studentore. <i>(Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale, pika B.I.3.1.d (Ref.Nr.32.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ evidenton se Zyra për Këshillimin e Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledhë dhe përpunon të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Këtë analizë e kishte bërë për disa programe e studimit në të cilat ka studentë të diplomuar. Gjatë bisedës në Institucion, GVJ-së në takimin me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, si dhe me studentët e këtij program studimi u bë me dije se një pjesë e studentëve të vitit të trete tashmë ishin angazhuar në internshipe. <i>(Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre (Ref. Nr. 29)</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konfirmon se UET, disponon strukturën dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 103, Pika 1. Në manualin e Cilësisë UET përcaktohen korniza e sigurimit të cilësisë, bordi i administrimit dhe njësitë përkatëse.</p> <p><i>(Statuti UET, Neni 11&16 (Ref. Nr. 2);</i> <i>Rregullore UET, Neni 6 (Ref. Nr. 5);</i> <i>Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i Brendshëm i Cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha njësitë organizative të UET. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka si përfaqësues një koordinator nga secila njësi kryesore e UET dhe përfaqësues nga studentët.</p> <p><i>Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC_Tabela 24 Aneks (Ref. Nr. 30; Urdhër mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga Shqyrtimi i dosjes së dorëzuar të GVB, konstatoam se grupi ynë i akreditimit për programin Fizioterapi, është duke kryer procesin e parë të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.</p> <p>Në këtë drejtim, në UET është zbatuar procesi i kontrollit të ligjshmërisë i ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET plotësonte standardet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e aktivitetit akademik; janë zhvilluar vizita monitoruese të MASR mbi përmbushjen e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, vërejtëm se, veprimtaria e KSBC mbështetet në dokumentet e saj strategjike dhe zhvillohet e organizuar sipas një plani kalendar (Plani i veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet dhe gjetjet përkatëse. Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p><i>(Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)</i> <i>Plani i veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëtit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	KSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm kanë departamentet si njësia përgjegjëse për programin e studimit, ku përgjegjësit e grup-lëndëve/ koordinatorët e programeve kanë detyra specifike që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, silabuseve dhe literaturës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe standardet dhe Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së UET. <i>Vendimi për emërimin e Koordinatorëve të programeve të studimit (Ref. Nr. 36); Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Procedurat e rishikimit periodik të programeve të studimit, përgatiten dhe shpërndahen në formën e një raporti vlerësues periodik mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/ prezantimit në nivel Rektorati, sikurse dhe në nivel departamenti. <i>(Metodologjia e punës së KSBC_Provimet (Ref. Nr. 30.5)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. KSBC njëherazi, rekomandon detyra, zbatimit të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe nga vet Komisioni. <i>(Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 30.7)</i>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit. <i>(Format i relacionit për monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 37)</i>
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive. <i>(Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.3-7 (Ref. Nr. 8)</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfaqëson këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se në mënyrë periodike institucioni është kujdesur për vlerësimin e brendshëm si në nivel fakulteti ashtu dhe departamenti duke hartuar raport përkatës të veprimtarisë.</p> <p>Ky raport shërben si dokument bazë për vetëvlerësimin e programeve të studimit. Gjithashtu raportet e vlerësimit të brendshëm ishin pjesë e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të akreditimit institucional.</p> <p><i>(Takimi me KSBC)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas takimit me përfaqësues të institucionit metoda e përdorura përfshijnë instrumenta për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësinë e literaturës, proceset didaktike të përdorura dhe konferencat e realizuara.</p> <p>Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, realizon pyetësorë, ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen etj. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të ndryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga punë dhënës të ndryshëm.</p> <p>Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.</p> <p>UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuara; - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me pikë; - Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; praktikë; - Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës.
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eperi (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. <i>(G.III.4.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref. Nr. 30.8)</i></p>

	<p>Në kushtet e vijimit të procesit akademik online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, sipas Vendimit të Senatit Akademik, monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundësuar nga Zyra e IT në UET nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi aksesimin e platformave nga stafi akademik/studentët dhe prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore janë monitoruar nga Përgjegjësi i Departamentit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të tij se ka zhvilluar pyetësor anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike.</p> <p>Metodat e tërthorta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve. • Sondazhe: të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit. • Pyetje konceptuale. • Intervista. <p>Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si dhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p><i>(G.III.4.2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në manualin e Cilësisë të UET, përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p> <p>Gjatë periudhës 2016-2019, UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe projekti Erasmus+ QAINAL. Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të</p>

	<p>brendshëm të cilësisë. Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me fokus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+ KA1.</p> <p><i>Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9);</i> <i>Fisha e projektit QAINAL (Ref. Nr. 30.10)</i> <i>Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3); Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43))</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësim përmes anketimit, dhe forumeve të debatit. Përfshihen edhe në vendimmarrje përmes përfaqësisë së tyre në Senatin Akademik, si pjesë e Qeverisjes së UET, përfaqësisë në Komisionin e Etikës, Këshillit studentor, si dhe përfaqësisë në NJSBC.</p> <p><i>Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit Administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit.</p> <p><i>(Takimet ne Institucion)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Fakulteti është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të gjithë palëve të përfshira në këtë proces.</p> <p>Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, DIF ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.</p> <p>Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përbushjes së standardeve të cilësisë.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikak që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UET është i aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar, Planit të veprimit, të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet e detajuara dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse. <i>Plani i Veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)</i>
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej tyre konstatohet se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. Kanë miratuar rregullore për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen web publikohen të gjitha politikat dhe praktikak e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. <i>(Takimi me KSBC)</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nisur nga analiza e raporteve të vlerësimit, Stafet angazhohen në plotësimin e rekomandimeve, ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. <i>(Takimi me KSBC)</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se ai vlerëson dhe përpiket për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Konkretisht cdo vit realizohet analiza e punës mësimore e cila shoqërohet nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve 186 e koordinatorit të programit, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>(Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13)</i> <i>Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe	Mbledhjet e Asamblesë Akademike si dhe mbledhjet e Departamentit, përbëjnë dhe mënyrat më të shpeshta të informimit mbi arritjet dhe problematikave; në këto mbledhje bëhet identifikimi i nevojave për ndërhyrje për përmirësim. <i>(Takimi ne Institucion)</i>

përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Fizioterapi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”


Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe sistem e-learning në shërbim të studentëve dhe personelit akademik.
2. Përdorimi i literaturës bashkëkohore ndërkombëtare e viteve të fundit, sidomos për lëndët e profilit fizioterapeutik jo vetëm.
3. Personeli akademik cilësor i angazhuar në mësimdhënie ka grada e tituj, konform përcaktimeve ligjore, dhe përfaqësohet nga anëtare me eksperiencë në mësimdhënie dhe përvojë profesionale në fusha të ndryshme të shkencave mjekësore që ndërthuren me pedagogë/ staf të ri të kualifikuar i gatshëm për tu promovuar.
4. Mbështetja dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit akademik dhe njohja e tyre me metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, publikimi i revistës shkencore të Fakultetit: Medicus (<https://uet.edu.al/medicus/>).
5. Marrëveshjet me institucionet shëndetësore, qendra spitalore si brenda dhe jashtë vendit, ofrojnë mundësinë e trajnimit dhe kualifikimit të mëtejshëm dhe i bën ata të jenë të gatshëm për tregun e punës menjëherë pas diplomimit.
6. Aplikimi i bursave të ekselencës nëpërmjet aktiviteteve të përvitshme si “tour”-eve në gjimnaze, Shkolla Dimërore, Klubet Studentore, trajnimeve profesionale si dhe mbështetja e tyre me bursë studimi që nxisin ruajtjen e rezultateve të larta akademike, janë një investim i UET që shkon drejtpërdrejt në shërbim të rritjes së cilësisë së studentëve që pranohen në program, e si rrjedhojë edhe të ofrimit në të ardhmen e një stafi të kualifikuar në institucionet ku ata do të punësohen.

Pika të dobëta:

1. Mobiliteti i studenteve dhe stafit akademik duhet të jete me i lartë në menyrë që të mundësohet një kontakt i vazhdueshëm me metodat bashkëkohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe administrimit në shërbim të programit të studimit dhe institucionit.
2. Pavarësisht disponibilitetit të literaturës së nevojshme për programin e studimit të Fizioterapisë në formatin elektronik biblioteka nuk është e pajisur mjaftueshëm me tekste për fushën e fizioterapisë në hard copy në dispozicion të studentëve.
3. Institucioni haset në vështirësi në diversifikimin e burimeve të financimit dhe mbështet kryesisht në tarifën e studimit.

Rekomandime:



1. Të mundësohet nga institucioni përkthimi/ përshtatja i teksteve pjesë e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në gjuhën shqipe në mënyrë që të lehtësohet aksesimi i informacioneve nga studentët e nivelit bachelor.
2. Rekomandojmë që institucioni të promovojë dhe të mundësojë diversifikimin e burimeve të financimit për programin e studimit i cili aktualisht mbështetet kryesisht në tarifën e shkollimit të studentëve.
3. Pavarësisht zhvillimit dhe mundësive gjithnjë në rritje për tu përfshirë në projekte ndërkombëtare, për shkëmbim eksperience dhe zhvillim kapacitetesh në kuadër të bashkëpunimit me institucionet partnere ndërkombëtare, rekomandojmë që përqindja e studentëve ose anëtarëve të stafit akademik pjesëmarrës në mobilitete të rritet.
4. GVJ rekomandon pavarësisht praninë e kabinetit të fizioterapisë, paisjen me aparaturë të nevojshme për zhvillimin cilësor të orëve të laboratorit, si dhe zgjerimin e hapësirës për kabinetin e fizioterapisë.


**Conclusions of the evaluation of the study program of the first cycle Bachelor
“Physiotherapy” of the Institution of Higher Education “European University of Tirana”**

Strengths and affirmations:

1. Teaching based on modern methods and e-learning system at the service of students and academic staff.
2. The use of contemporary international literature of recent years, especially for subjects of physiotherapeutic profile, but not only.
3. Qualitative academic staff engaged in teaching has degrees and titles, in accordance with legal provisions, and is represented by members with experience in teaching and professional experience in various fields of medical sciences who interact with new qualified lecturers/staff ready to promoted.
4. Continuous support and training of academic staff and their familiarity with the most modern methods of teaching and research, publication of the scientific journal of the Faculty: Medicus (<https://uet.edu.al/medicus/>).
5. Agreements with health institutions, hospital centers both inside and outside the country, provide the opportunity for further training and qualification and make them ready for the labor market immediately after graduation.
6. Applying for scholarships of excellence through annual activities such as “tours” in high schools, Winter Schools, Student Clubs, vocational training and their support with scholarships that promote the preservation of high academic results, are an investment of UET which goes directly to the service of increasing the quality of students admitted to the program, and consequently the provision in the future of a qualified staff in the institutions where they will be employed.

Weaknesses:

1. The mobility of students and academic staff should be higher in order to enable a continuous contact with modern methods of teaching, research and administration in the service of the study program and the institution.
2. Despite the availability of the necessary literature for the study program of Physiotherapy in electronic format, the library is not sufficiently equipped with texts for the field of physiotherapy in hard copy available to students.
3. The institution encounters difficulties in diversifying funding sources and relies mainly on tuition fees.

A handwritten signature in blue ink is written over a large, irregular blue stamp or seal.

Recommendations:

1. To enable the translation/adaptation of texts part of the compulsory and auxiliary literature in the Albanian language by the institution in order to facilitate the access of information by bachelor students.
2. We recommend that the institution promotes and enables the diversification of funding sources for the study program which currently relies mainly on student tuition fees.
3. Despite the ever-increasing development and opportunities to be involved in international projects, for the exchange of experience and capacity development in the framework of cooperation with international partner institutions, we recommend to increase the percentage of students or academic staff members participating in mobility programs.
4. The External Evaluation Group recommends, despite the presence of the physiotherapy cabinet, the equipping with the necessary instruments for the quality development of the laboratory hours, as well as the expansion of the space for the physiotherapy cabinet.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

